Llojet e vlerësimeve: ekzistojnë lloje të ndryshme të vlerësimit të njohurive të nxënësve si: vlerësimi diagnostik (identifikimi i aftësive dhe vështirësive të nxënësve në mësim); vlerësimi i jashtëm (vlerësim nëse njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi të kalojë në klasën e radhës); vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë); vlerësimi parashikues (parashikim i dështimeve dhe sukseseve potenciale të nxënësve ; vlerësimi përfundimtar (përparimi i nxënësve dhe rezultatet e arritura në mësim); vlerësimi selektiv (vetëvlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe problemeve të tyre në mësim).

Çfarë duhet të vlerësohet? Të kontrollohen njohuritë e fituara; përparimi i nxënësve; shkalla e zhvillimit të nxënies; shkalla e zotërimit të Gjuhës frënge; shkalla e integritetit të njohurive të fituara; aktivitetet jashtëshkollore.

Mënyrat e vlerësimit: kontrolli i vazhdueshëm; vlerësimi i drejtpërdrejtë (me tabelë); vlerësimi i tërthortë (me test); vlerësimi objektiv (me tabelë); vlerësimi subjektiv (pa tabelë); vlerësimi nga nxënësit (vlerësimi i njëri-tjetrit); vlerësimi në grupe nxënësish brenda klase (me tabelë); vetëvlerësimi i nxënësve (secili nxënës vlerëson vetveten).

Kriteret e vlerësimit: aktivitetet e të shprehurit; të shprehurit gojor; të shprehurit me shkrim; aktivitetet e receptimit (të kuptuarit gojor dhe të kuptuarit me shkrim); aktivitetet e riprodhimit (të shprehur me gojë dhe me shkrim. Notat sipas shkathtësive: të dëgjuarit; të folurit; të lexuarit; të shkruarit (5, 4, 3, 2, 1).

Notat	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit
5				
4	X			
3		X	X	
2				X
1				

7. Materialet dhe burimet mësimore

Për arritjen e kompetencave të nxënësve në gjuhën frënge është i rëndësishëm përdorimi i materialeve dhe burimeve të ndryshme mësimore për mësimdhënie dhe nxënie. Për realizimin e rezultateve të fushës dhe për arritjen e suksesshme të rezultateve për lëndë, të gjitha mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përmbahen kërkesave të këtyre rezultateve. Tekstet shkollore për Gjuhën frënge që (mund të) përdoren në Kosovë janë vetëm disa nga burimet për marrjen e informacionit, pasi ato nuk janë hartuar në përputhje me kurrikulën lëndore të Gjuhës frënge për klasën e 6-të.



Programi mësimor: Art figurativ

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Lënda Art figurativ për klasën e gjashtë është një nga lëndët e rëndësishme brenda fushës kurrikulare Artet, e cila së bashku me lëndët e tjera të kësaj fushe ka një ndikim dhe rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve dhe kultivon kulturën artistike, intelektuale, shpirtërore dhe emocionale tek ata.

Përmes artit zhvillohen vlerat shoqërore dhe formimi i personalitetit dhe identitetit personal e kulturor, duke kontribuar në arritjen e kompetencave e të nxënësve të Kurrikulës Bërthamë.

Lënda Art figurativ në klasën e gjashtë fokusohet në zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të njohurive dhe shkathtësive të artit dhe përdorimin e tyre në krijimtari artistike duke zhvilluar kreativitetin, imagjinatën, mendimin kritik dhe shijen estetike.

Arti figurativ jep mundësi shprehëse dhe komunikuese nxënësve për të pasqyruar idetë dhe qëndrimet e tyre përmes veprave artistike.

Lënda e artit synon të vë në pah rolin dhe rëndësinë e artit për shoqërinë njerëzore në përgjithësi dhe zhvillimin e shkathtësive krijuese dhe talentit artistik të nxënësve me prirje artistike si një mundësi për studime të mëtutjeshme në krijimin e individualitet të tyre artistik e profesional.

2. Qëllimi

Lënda e Artit figurativ për klasën e gjashtë, nëpërmjet përmbajtjeve të përcaktuara sipas tematikave, ka si qëllim:

- Zgjerimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve në art figurativ;
- Zhvillimin dhe formimin estetik, artistik, personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve;
- Njohjen e rolit dhe rëndësisë së artit për individin dhe shoqërinë;
- Zhvillimin e shkathtësive kreative e artistike për të komunikuar ndjenjat, idetë dhe mendimet përmes punimeve artistike;
- Shkathtësinë e përdorimit të elementeve dhe parimeve të artit në punime artistike;
- Njohjen dhe përzgjedhjen e materialeve, teknikave dhe mjete të ndryshme artistike dhe përdorimi i tyre në vepra arti;
- Kultivimin e shijes dhe përjetimit estetik të veprave të artit;
- Zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive për të vlerësuar dhe analizuar vepra arti;
- Zhvillimin e aftësisë për të identifikuar veprat e artit nëpërmjet periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve.

3. Temat, rezultatet dhe të nxënësve

Nxënësist në klasën e gjashtë arrijnë rezultatet e të nxënësve të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënësve të fushës (RNF) Artet, të shkallës së tretë të kurrikulës (Shk 3) në Kurrikulën Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE	<p>RNF: 1. Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në Muzikë, Dramë, Arte pamore e vallëzim.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale. • Vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plastelinë, letër e materiale të tjera) në mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara; 	
	<p>Tema</p> <p>Krijimi i punimeve (Vizatimi, Piktura, Grafika, Dizajni Grafik, Modelimi, Konstruksioni</p>	<p>Rezultatet e të nxënës të lëndës për temë (RNL)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizon punime dy dhe tri dimensionale duke përdorur teknika dhe medime të ndryshme të artit; • Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit; • Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike; • Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin, etj.); • Realizon punime në teknikat e grafikës duke mësuar veçoritë dalluese të saj; • Modelon vepra skulpturale në relief dhe skulpturë tridimensionale duke përdorur forma të ndryshme; • Përzgjedh dhe përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme; • Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale; • Manipulon me imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike; • Realizon punime nga arti aplikativ duke bërë dallimin nga arti figurativ; • Realizon piktura aplikative në teknikën e mozaikut dhe kolazhit; • Realizon punime të ndryshme në dizajnë të produkteve të ndryshme; <p>Përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniaturë;</p>

		<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizon punime dy dhe tri dimensionale duke përdorur teknika dhe medime të ndryshme të artit; • Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit; • Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike; • Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin, etj.); • Realizon punime në teknikat e grafikës duke mësuar veçoritë dalluese të saj; • Modelon vepra skulpturale në relief dhe skulpturë tredimensionale duke përdorur forma të ndryshme; • Përzgjedh dhe përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme; • Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale; • Manipulon me imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike; • Realizon punime nga arti aplikativ duke bërë dallimin nga arti figurativ; • Realizon piktura aplikative në teknikën e mozaikut dhe kolazhit; • Realizon punime të ndryshme në dizajn të produkteve të ndryshme; • Përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniaturë.
<p>GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK</p>	<p>RNF: 2.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta. 2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura. 3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre. 4. Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (Muzikë, Dramë, vallëzim dhe Arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audiencën të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).

	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
	Elementet figurative	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon, përshkruan dhe përdor elementet dhe parimet e gjuhës figurative; • Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të vijave për të realizuar punime artistike; • Dallon lloje të ndryshme të formave dhe realizon punimi duke përdorur elementin e formës; • Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike; • Identifikon dhe përdor llojet e ndryshme të toneve në vepra artistike; • Shpjegon rëndësinë e dritëhijes dhe aplikon atë në vepra të artit; • Dallon dhe aplikon vëllimin në vepra dy dhe tri dimensionale; • Përdor lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me teksturë; • Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës duke përdorur parimin e perspektivës për të arritur iluzionin e hapësirës në punime artistike; • Dallon rregullat e kompozimit dhe i përdor ato për të kompozuar vepra artistike;
	Parimet e artit	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dhe aplikon llojet e ndryshme të kompozicionit në punimet e tyre artistike; • Identifikon llojet e ndryshme të baraspeshave dhe përdor ato në vepra artistike; • Identifikon llojet e ndryshme të harmonive duke realizuar një punim me parimin e harmonisë; • Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e saktë të raportit në mes të formave të ndryshme; • Dallon lloje të ndryshme të sipërfaqeve edhe aplikon ato në punime artistike; • Analizojnë ritmin në punime të ndryshme të artistëve të njohur dhe aplikojnë lloje të ndryshme të ritmit në punët e tyre; • Identifikojnë rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti; • Përdorin lloje të ndryshme të kontrastit në punime artistike;

RELACIONI ART – SHOQËRI	<p>RNF: 3.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme; 2. Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. ; 3. Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore (lokal, regjional, kombëtar, global etj.) ; 	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
	<p>Ekspozita dhe aktivite kulturore</p> <p>Vizita dhe ngjarje artistike (<i>Vizita në Galeri, muzeume, objekte të trashëgimisë kulturore, atele (studio) të artistëve, qendra kulturore etj.</i>)</p> <p>Periudha historike: (<i>Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore, Arti në parahistori, Arti i Mesopotamisë, Arti Egjiptian, Arti antik Grek, Arti Romak, Arti Islam</i>)</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë, Galeri e komunitet; • Viziton atelet dhe studio të artistëve, dhe ndanë eksperiencat me artistët profesionist; • Viziton institucione të ndryshme të artit si muze, galeri, qendra kulturore, vizita virtuale në internet në faqe të ndryshme etj.; • Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha; • Dallon disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike; • Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.
		<p>RNF: 4.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Komentojnë dhe shprehën për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, powerpoint prezantim e forma të tjera shprehëse. 2. Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate. 3. Çmojnë veprat e trashëgimisë kulturore – popullore në ambientin ku jetojnë.

ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
	Vlerësimi i Periudhave dhe drejtimeve të artit Vlerësimi i Veprave artistike Analiza e punimeve Debate për trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Prezanton dhe përshkruan punimet e tij, para klasës; • Analizon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike; • Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupore brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollore.

4. Udhëzime metodologjike

Për organizimin sa më të mirë të procesit mësimor, për një mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme dhe për realizimin e plan-programit mësimor në lëndën e Artit figurativ duhet të përdoren metodologji të ndryshme të mësimdhënies. Këto metodologji janë në shërbim të rritjes së cilësisë së sukseseve dhe arritjeve të mësimnxënës nga ana e nxënësve, duke i ofruar mundësinë që të shfaqin dhe të zhvillojnë potencialin krijues/artistik që zotërojnë brenda vetes.

Metodologjitë duhet të jenë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, koncepteve, shkathtësive dhe Metodologjitë duhet të jenë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, koncepteve, shkathtësive dhe në harmoni me rezultatet e të nxënit të lëndës së artit figurativ (RNL), fushës së arteve (RNF) dhe kompetencave kryesore të Kurrikulës Bërthamë (RNSH).

Përzgjedhja e metodologjive është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës, dhe ato përzgjidhen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Duke marrë për bazë natyrën e lëndës së artit figurativ që më tepër është veprimtari praktike, ku nxënësit realizojnë vepra të ndryshme artistike, edhe metodologjitë përzgjidhen në atë mënyrë që nxënësi të motivohen për pjesëmarrje aktive në këto aktivitete si një mundësi që ata përmes përdorimit të mjeteve të larmishme artistike të reflektojnë idetë, qëndrimet dhe mendimet e tyre.

Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin figurativ.

Mësimdhënia në artin figurativ synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet në mësimdhënien dhe nxënien, bazuar në kompetenca, në mësimdhënien me nxënësin në qendër dhe mësimdhënien - nxënien e integruar.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit figurativ merr parasysh:

- Zhvillimin dhe forcimin e njohurive dhe shkathtësive bazë të artit figurativ duke u mbështetur në ato paraprake;
- Kompetencat kryesore të të nxënësve në artin figurativ;
- Nxitjen e të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- Motivimin e nxënësve, për krijimtari artistike dhe punë të pavarur
- Rëndësinë e veprimtarive praktike në artin figurativ, brenda dhe jashtë klasës
- Rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- Veçoritë e veprimtarive individuale dhe në grup;
- Nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit figurativ dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- Nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në procesin mësimor;
- Eksperiencat gjatë vizitave nëpër institucione të artit (galeri, muze).

Secila metodologji duhet të jetë në shërbim të interesave dhe nevojave të nxënësve dhe t'i inkurajojë ata të kenë besim në arritjen e suksesit në fushën e artit.

Për të zhvilluar suksesshëm procesin mësimor, mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë, të stimulojë dhe inkurajojë nxënësit për pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme duke planifikuar shumëllojshmëri aktivitete, materialesh, teknikash dhe informacionesh ku nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar sa më shumë mbi artin figurativ.

Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave figurative/artistike.

Format e punës në lëndën Art Figurativ

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të lëndës së artit figurativ aplikohen forma të ndryshme të punës:

- individuale
- në çifte
- në grupe
- me tërë klasën

5. Çështjet ndërkurrikulare

Në sistemin arsimor **çështjet** ndërkurrikulare janë tema të rëndësishme përmes të cilave nxënësit fitojnë, zhvillojnë dhe përvetësojnë disa aftësi dhe njohuri specifike, në mënyrë që të përgatiten për jetën dhe punën në të ardhmen dhe të përballojnë dhe tejkalojnë me lehtë sfidat e jetës.

Çështjet ndërkurrikulare janë tema me të cilat vazhdimisht është ballafaquar shoqëria njerëzore, të cilat synojnë krijimin dhe kultivimin e disa vlerave shoqërore, humane e njerëzore, të cilat kontribuojnë në formimin e identitetit dhe personalitetit individual dhe të pavarur të nxënësve.

Çështjet ndërkurrikulare janë çështje që domosdo janë të ndërlidhura me rezultatet e fushave ku integrohen dhe kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare në forma të ndryshme duke përfshirë edhe e fushën e arteve me lëndët e saj, e cila i ndihmon nxënësit të njohin, kuptojnë dhe të interpretojnë më mirë botën, ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, temat dhe njësitë mësimore dhe të parasheh se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi sa më i mirë i këtyre çështjeve duke marrë parasysh edhe mësimdhënien e integruar.

Çështjet ndërkurrikulare që mund të ndërlidhen dhe trajtohen në lëndën artit figurativ janë:

- Edukimi për media
- Edukimi për paqe
- Edukimi për qytetari demokratike
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Të drejtat dhe liritë e njeriut
- Zhvillimi i qëndrueshëm.

Edukimi për media - edukimi për përdorimin e medias është një imperativ i kohës për nxënësit, e cila u siguron informacione për zgjerimin e njohurive të tyre mbi zhvillimet historike të artit, autor, vepra arti, teori dhe problem artistike, duke zhvilluar dhe kultivuar shkathhtësinë dhe kulturën hulumtuese për trajtimin e problemeve të caktuara. Gjithashtu medien mund ta përdorin edhe për krijime artistike dhe prezantimin e projekteve të ndryshme artistike.

Edukimi për paqe - Nxënësit në lëndën e artit mund të trajtojnë dhe realizojnë tema që kanë të bëjnë me paqen, respektimin e dinjitetit njerëzor, diversitetit kulturor, toleranca, humanizmi, harmonia dhe bashkëjetesa.

Edukimi për qytetari demokratike - Në temën "Edukimi për qytetari demokratike" përmes artit nxënësit mund të trajtojnë tema për qytetërimet dhe demokracinë dhe në këtë formë të formojnë identitetin e tyre qytetar e kulturor, si qytetar aktiv për mirëqenien e tyre dhe të

komunitetit.

Globalizimi dhe ndërvarësia - Nxënësit trajtojnë tema që kanë të bëjnë me epokën e globalizimit në sfera të ndryshme shoqërore si në art, kulturë, ekonomi, arsim etj. Dhe ndërvarësia dhe raporti i zhvillimeve të kulturave të ndryshme shoqërore, duke krijuar një këndvështrim pozitiv e pranues ndaj këtyre përvojave dhe kulturave.

Të drejtat dhe liritë e njeriut - Nxënësit trajtojnë përmes artit tema që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, duke kultivuar kulturën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut pa marrë parasysh, gjininë, racën, nacionalitetin etj.

Zhvillimi i qëndrueshëm - zhvillimi i qëndrueshëm është një proces i cili i përgatitë nxënësit me aftësi të qëndrueshme që garanton mundësitë për një jetë më të mirë. Nxënësit duhet të aftësohen të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, që kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi shoqërinë, në aspektin kulturor-artistik, social, ekonomik dhe mjedisor.

6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Vlerësimi përfshin tërë veprimtarinë dhe konsiderohet si element i mësimdhënies që ndihmon mësimdhënësit për ndjekjen e zhvillimit gradual në arritshmërinë e rezultateve të të nxënësve në nivel klase dhe shkolle të nxënësve si dhe zotërimin e kompetencave. Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore në arritjen e rezultateve mësimore dhe kompetencave të përcaktuara për këtë nivel, po ashtu, metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të nxënësve ngase është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore.

Ky proces vlerësimi shtrihet që nga vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezantimi me gojë dhe me shkrim, testimi, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.

Vlerësimi në artin figurativ, mbështetet në parimin e individualizimit, ngase arritjet janë më shumë individuale, ku çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e shprehjes artistike.

Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale, krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte.

Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grupe, në aktivitetet të ndryshme artistike, që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi individual bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli me krijimet, shkrimet, prezantimet dhe testimi janë një mundësi objektive e vlerësimit të nxënësve, pasi i përgjigjet edhe vlerësimit sipas kompetencave të lëndës së artit

figurativ.

Qëllimet e vlerësimit:

- Të identifikohet përparimi i nxënësve dhe t'u ofrohen të dhëna të mjaftueshme;
- Të motivohen nxënësit për punë;
- Të sigurohen informacione për shkallën e arritshmërisë së kompetencave;
- Të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe të forta tek nxënësit;
- Të përmirësohen nxënësia dhe mësimdhënësia;
- Të japin detyra sipas aftësive individuale në përputhje me nivelin e nxënësve;
- Të përzgjedhin metoda të përshtatshme gjatë mësimdhënies, bazuar në nivelin e klasës;
- Të sigurohen informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm.

Format dhe instrumentet e ndryshme të vlerësimit

Gjatë procesit të vlerësimit sugjerohet që mësimdhënësit të përdorin forma dhe instrumente të ndryshme vlerësimi, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe lloje të tjera të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet të cilat ata i synojnë. Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit. Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithmonë duhet të jetë transparente dhe e drejtë. Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standardet më të larta etike. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv.

Metodat e vlerësimit

- **Vlerësimi verbal** - përdorimi i pyetjeve të shkurtra, biseda rreth materialit mësimor apo një detyre konkrete, duke diskutuar me nxënës të veçantë, grupe apo me gjithë klasën, duke dëgjuar diskutimet që bëjnë nxënësit me njëri - tjetrin për një koncept, mbi njohuri të arteve figurative, vepër apo detyrë artistike etj.
- **Vlerësimi me shkrim ose testimi** - detyra të veçanta për grupe nxënësish, teste të shkurtra për një koncept, temë apo dhe një grup temash, për një ese si dhe testime për një linjë të caktuar, semestrale dhe vjetore.
- **Vlerësimi i detyrave të realizuara** - vëzhgimi hap pas hapi i detyrave të artit, që nga ideimi deri tek organizimi dhe realizimi si p.sh: demonstrimi i arritjeve në punë konkrete (fjala vjen realizimi i punëve dy dhe tredimensionale, interesimi për ndjekjen e jetës artistike në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi ndaj kësaj lënde etj).
- **Vlerësimi i projekteve të ndryshme**-bashkëpunimi i nxënësve në një projekt në bazë

shkolle apo krahine.

-
- **Vlerësimi i punëve artistike** - marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj., pjesëmarrja në veprimtari kombëtare si: konkurset, ekspozitat në shkallë vendi apo më gjerë.
-
- **Vlerësimi përmes portofolit** - portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), krijime të ndryshme dy dhe tredimensionale të realizuara gjatë vitit shkollor që mund të jenë krijime në pikturë, skulpturë (plastelinë), kompjuter etj., projekte kurrikulare, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

Instrumentet e procesit të vlerësimit

- Testi (me shumë zgjidhje, saktë- gabim, përputhje, plotësim, përgjigje e shkurtër dhe kërkesa të hapura)
- Testi i strukturuar me gojë
- Lista e kontrollit
- Pyetëtori
- Fleta për intervista
- Anketa
- Eseja
- Projekti
- Dosja/Portofoli

7. Materialet dhe burimet mësimore

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave.

Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e artit, dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Teknologjia është një nga mjetet me përdorim të gjerë në lëndën e artit figurativ duke ndihmuar nxënësit të hulumtojnë dhe njohin vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj., duke krijuar tipin studiues të nxënësve në lëndën e artit. Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të planprogrameve të lëndëve të caktuara, në këtë rast edhe të lëndës së artit.

Në këtë formë nxënësve u krijon mundësinë të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medimeve teknologjike detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësimdhënësi nxit interesimin e nxënësve për veprimtari dhe trajtim të temave të artit duke përdorur një fjalor të pasur të gjuhës artistike figurative me fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore e konceptuale.

Mësimdhënësi nxit zgjerimin e njohurive mbi artin te nxënësit duke i motivuar që të përdorin burime, materialeve dhe tekste (Libra) të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – figurative: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, vazo, riprodhime të veprave të artit dhe postera, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – figurative-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;
- Mjedisi mësimor (klasa, atelieja, kabineti, natyra, galeria, muzeu etj.).

Programi mësimor: Muzikë

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Muzika kontribuon në zhvillimin fizik, emocional, intelektual, social dhe estetik të fëmijës, pra në formimin e gjithanshëm e posaçërisht në formimin kulturor të fëmijëve duke e pasuruar botën e tyre shpirtërore, identitetin dhe personalitetin.

Me gjuhën universale të cilën e kuptojnë të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie, e moshe, muzika u ndihmon nxënësve të kuptojnë dukuritë dhe proceset muzikore për t'i shfrytëzuar ato për komunikim dhe shprehje artistike në kontekste të ndryshme.

Si aktivitet shoqëror që në zanafillën e paraqitjes së saj, muzika është medium që mundëson aktivitete të përbashkëta grupore ku kërkohet bashkëpunimi në realizimin e këngëve, pjesëve muzikore me instrumente etj, duke iu mundësuar nxënësve që të zhvillojnë shkathtësitë e ndryshme muzikore krahas zhvillimit të kompetencave të tjera të përgjithshme .

2. Qëllimi

Lënda Edukatë muzikore e klasës së VI-të synon kryesisht të:

- Identifikojë prirjet dhe zhvillojë shkathtësitë muzikore të nxënësve sipas interesimit dhe dispozitave individuale-veshin muzikor, këndimin, luajtjen në instrumente etj.;
- Pasurojë "fjalorin" e termeve dhe te koncepteve bazike të gjuhës muzikore për të mundësuar komunikimin artistik dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të nxënësve për ritmin, melodinë, harmoninë, format muzikore, instrumentet, institucionet, krijuesit dhe performuesit;
- Aftësojë nxënësit që të familjarizohen me dëgjimin aktiv muzikor dhe të çmojnë e vlerësojnë krijimtarinë muzikore (kombëtare dhe botërore) të stileve dhe zhanreve të ndryshme muzikore;
- Nxis nxënësit që të provojnë aftësitë e tyre krijuese muzikore;
- Identifikojnë krijuesit dhe performuesit, institucionet dhe ngjarjet e rëndësishme muzikore.

3. Temat dhe rezultatet e të nxënit

Rezultatet e të nxënit të fushës (RNL) zbërthehen dhe specifikohen me anë të rezultateve të të nxënit të lëndës të organizuara në 4 tërësitë tematike kryesore.

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
	RNF.1.	
	<p>Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në Muzikë, Dramë, Arte pamore e vallëzim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal; <p>Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë; • krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve 	
Krijimtaria dhe performanca artistike	Këngët	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit këndojnë melodi të thjeshta me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit ose me tekst notal (së paku 8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur;
	Interpretim në instrumente	<ul style="list-style-type: none"> • Luajnë në instrumente, individualisht dhe në grupe (së paku 3 -5 pjesë instrumentale);
	Kreativiteti muzikor	<ul style="list-style-type: none"> • Improvizojnë ritme dhe melodi në masën 2\4, 3\4, 4/4 dhe \5\8, e 6\8; <p>Shprehen me mjete shprehëse të arteve mbi Muzikën e dëgjuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provojnë të krijojnë melodi të reja për ritme e tekste të shkurtra poetike të përzgjedhura.
	RNF.2.	
	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta; • Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe teknikave të përdorura; • Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre; • Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (Muzikë, Dramë, vallëzim dhe Arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audiencën të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.). 	

<p>Gjuha dhe komunikimi artistik</p>	<p>Elementet muzikore</p> <p>Ritmi</p> <p>Harmonia</p> <p>Melodia</p> <p>Forma</p>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallojnë elementet muzikore (ritmi, masat, melodia, harmonia, shkallët muzikore etj) në veprat që dëgjojnë; • Përdorin elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore; • Identifikojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore(dy pjesore dhe tre pjesore, minuet, vals etj);
	<p>Shkrim - leximi Muzikor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrokjet e solmizimit • Simbolet për gjatësinë e tingullit muzikor <p>Shkallët muzikore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • identifikojnë simbolet muzikore për lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore (rrokjet e solmizimit, vlerat e notave) të këngëve që këndojnë; • Identifikojnë parimin e ndërtimit të shkallëve muzikore (C-Dur-a-mol, G-Dur-emol dhe F-Dur-d-mol) përmes këngëve, shembujve muzikorë për dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore;
<p>RNF.3.</p>		<ul style="list-style-type: none"> • Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme; • Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile të ndryshme etj. • Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore(lokal, regional, kombëtar, global etj.).

Muzika dhe shoqëria	Zhanret muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Dallojnë zhanret muzikore (Muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok, festive etj),përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë;
	Gjinitë (llojet) muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Dallojnë p
	Instrumentet dhe formacionet muzikore Krijuesit dhe performuesit	<ul style="list-style-type: none"> Dallojnë përmes dëgjimit muzikor, instrumentet përfaqësuese nga grupet e instrumenteve harkore, frymore dhe me goditje; Dallojnë ansamblet e ndryshme muzikore sipas funksionit dhe llojit; Dallojnë përmes dëgjimit apo shfaqjes koncertale muzikën skeniket, koret dhe orkestrën; Njohin veprat artistike dhe krijues artiste të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.(së paku 10);
RNF 4.	<ul style="list-style-type: none"> Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, powerpoint prezantim e forma të tjera shprehëse; Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate; Çmojnë veprat e trashëgimisë kulturore-popullore në ambientin ku jeton; 	
Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik	Vepra muzikore Ngjarje muzikore	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësit shprehen për veprën e dëgjuar muzikore me vizatim,ese,poezi ose forma tjera shprehëse artistike (së paku 10 vepra); Nxënësit dallojnë karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin përmbajtjen); Nxënësit emërojnë përmes dëgjimit muzikor disa nga veprat e dëgjuara muzikore gjatë vitit (se paku 10); Nxënësit komentojnë ngjarje të ndryshme nga jeta artistike kombëtare dhe botërore; Nxënësit marrin pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

4. Udhëzimet metodike e metodologjike

Përjetimi artistik, kërshëria, imagjinata dhe liria e të shprehurit, janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Duke supozuar se është punuar shumë me përjetimin artistik në nivelin e parë, në këtë nivel në mënyrë graduale nxënësit njihen me konceptet e ndryshme, dukuritë dhe fenomenet muzikore përmes mësimdhënies intuitive dhe qasjes konstruktive të të nxënësve. Nxënësit njohin dhe kuptojnë proceset dhe teknikat

krijuese muzikore, duke mësuar si t'i zbatojnë në praktikë gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore. Artet ndërveprojnë mes vete, andaj edhe në procesin mësimor mund të ndërlidhen format e ndryshme të të shprehurit artistik, p.sh., kënga me lëvizjen dhe vallëzimin, muzika me shprehjen figurative, muzika me shprehja letrare, shprehja figurative me shprehjen letrare, performanca artistike sinkretike etj. Sidomos në këtë nivel, mund të aplikohet qasja e integruar e kombinimit të shprehjeve artistike për tema të ndryshme.

5. Çështjet ndërkurrikulare

Ndërlidhja e gjuhës (amtare dhe të huaj) me muzikën mund të jetë shumë e suksesshme. Çdo tematikë e veçantë dhe përmbajtje mësimore që përpunohet në këtë nivel bëhet më e qartë dhe më e kuptueshme kur shoqërohet me shprehje artistike (ilustrimet, grafikat, hartat, kënga, muzika, vallëzimet, videoklipi etj.)

Udhëzimet specifike metodike të mësimimit të muzikës në këtë klasë të elaboruara për secilën tërësi tematike e ndihmojnë mësimdhënësin që të planifikojë me kujdes orët mësimore gjatë një muaji, në mënyrë që ato të jenë të kombinuara dhe të mundësojnë arritjen e qëllimeve të lëndës.

Këndimi dhe luajtja në instrumente

Melodia dhe ritmi janë pjesë e pandashme e njohurive të domosdoshme që duhet të dijë nxënësit për kuptimin e muzikës. Këngët mësohen sipas veshit (imitimit) dhe gradualisht fillohet me prezantimin e sistemit notal: pentagrami, çelësi i solit, notat muzikore në vija dhe fusha, poshtë dhe sipër pentagramit të cilat mundësojnë edhe këndimin me tekst notal sipas mundësisë dhe prirjeve të nxënësve.

Teknikat dhe proceset muzikore vazhdojnë të zhvillohen më tej në këtë shkallë. Këndimi, luajtja në instrumentin e bokflautit por edhe instrumenteve të tjera muzikore zhvillohen nëpërmjet teknikave dhe ushtrimeve të vazhdueshme. Përmes të kënduarit zhvillohen më tej mënyrat e formësimit të zërit dhe të një të kënduari të saktë në intonacion e në një ritëm të caktuar. Përmbajtjet e këngëve janë të thjeshta dhe vazhdojnë të ruajnë tematika të tilla si: dashuria për familjen, shkollën, atdheun, këngët patriotike dhe festat e ndryshme, idetë dhe dëshirat e ndjenjat personale, si edhe temat nga çështjet ndërkurrikulare (paqja, tolerance, ambienti, etj) etj. Këngët për të rinj dhe ato popullore të përzgjedhura me kujdes sipas kriterëve të përzgjedhjes së këngës duhet po ashtu të përfshihen. Këngët duhet të jenë të thjeshta për nga shtrirja e regjistrimit vokal (zërit), melodia dhe në ritme e masa të ndryshme. Ndërsa luajtja në instrumentin blokflaut dhe instrumente të tjera muzikore (popullore dhe klasike me të cilat disponojnë fëmijët) bëhet sipas veshit (me imitim) për të shoqëruar këngët por nxiten nxënësit që edhe të interpretojnë individualisht dhe në grupe pjesë të shkurtra muzikore sipas tekstit notal .

Gjuha dhe komunikimi artistik - Trajtohen masat kryesore muzikore (2/4, 3/4, 4/4, 3/8 dhe 6/8) dhe simbolet të tjera si lidhja vlerës dhe shprehëse, shenja e përsëritjes të cilat mësohen vetëm konkretisht përmes këngëve dhe shembujve muzikorë. Gjatësia e vlerave të notave dhe pushimeve, sinkop, paraktik etj, tonaliteti, shkalla muzikore etj., do të zgjerohen më tej

njohuritë muzikore të nxënësit për kuptimin, krijimin ,interpretimin dhe gjykimin e saktë të muzikës që dëgjon apo performon.

Dëgjimi muzikor, çmuarja dhe vlerësimi - dëgjimi muzikor, përjetimi dhe të shprehurit emocional ndaj muzikës, është një proces shumë i rëndësishëm. Muzika krijon emocione të ndryshme dhe nxënësit duhet të nxiten që ti shprehin ato emocione të përjetuara. Dëgjimi aktiv muzikor kërkon përzgjedhjen e kujdesshme të veprave muzikore për dëgjim që ato të jenë të përshtatshme për aftësitë përjetuese të nxënësve. Muzika orkestrale është më atraktive për nxënësit e kësaj moshe, më e larmishme në ngjyra tingëllore, kurse muzika vokale-instrumentale është më konkrete për shkak të tekstit gjuhësor që e konkretizon përmbajtjen muzikore. Muzika programore P.sh Liqeni i Mjellmës, Muzika e ujit, Kalorësi i Eger, Fontana e Romes, Poema simfonike për Skënderbeun etj), po ashtu mundëson që nxënësit të jenë më afër përmbajtjes muzikore dhe mesazhit të këtyre veprave. Përdorimi i teknologjive të ndryshme ndihmon dhe është në funksion të kërkimit të të dhënave dhe të prezantimit të veprave muzikore për dëgjim (shembujt muzikorë dhe videot e interpretimeve të veprave të ndryshme muzikore në youtube, CD, video etj)

Nxënësit inkurajohen vazhdimisht që të çmojnë dhe vlerësojnë veprat e dëgjuara duke përdorur termet adekuate për elementet muzikore dhe shprehjen artistike.

Në lëndën e Muzikës në klasën e VI mund të trajtohen një varg çështjesh ndërkurrikulare.

Edukimi për demokraci dhe paqe- ka të bëjë me promovimin e përgjegjësisë, të drejtat e njeriut,të çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimin dhe luftimin e dukurive negative shoqërore, promovimin e dialogut, tolerancës etj. Këto tema mund të jenë subjekt i këngëve që nxënësit i këndojnë në klasë dhe në aktivitetet jashtëshkollore. Mund të organizohen projekte tematike në këto tema me ç’rast përzgjidhen këngët dhe veprat muzikore për dëgjim që kanë ndërlidhje me këto tema.

Ndërvarësia - nga perspektiva e arteve, vetë veprimtaritë artistike grupore e trajtojnë këtë temë, ngase p.sh kur duhet të realizohet një mural, mozaik, kolazh, ose makete grupore, të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë që pa bashkëveprimin e secilit nuk mund të realizohet tërësia e përbashkët. Muzikimi në ansambël, kor, orkestër realizohet vetëm duke respektuar bashkëveprimin dhe ndërvarësinë.

Edukimi për media - nga perspektiva e arteve, këtu përfshihen çështjet e përdorimit të drejtë të teknologjisë dhe medieve për krijimin dhe shpërndarjen e veprave artistike, por edhe edukimin e shijes estetike për artin që përfaqësohet në media(imazhet, muzika e mirë dhe jo e mirë, shpërndarja e muzikës përmes medimeve(e drejta autoriale, copyright etj) por edhe aplikimi i mediave për krijim artistik(fotografia, kolazhi etj).

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale bazuar në konventat ndërkombëtare mund të jenë objekt trajtimi i veprimtarive artistike(Muzikës, dramës, vallëzimit, arteve pamore dhe teknikave të ndryshme(postere, grafike, pikturë etj.).

Përdorimi i shprehjes artistike muzikore për të trajtuar të drejtën e fëmijës për shkollim, për liri e jetë të dinjitetshme, për dukuritë e ndryshme(p.sh., kundër duhanit, stop dhunës ndaj fëmijëve, stop luftës, etj), është i mundshëm përmes projekteve tematike në të cilat muzika merr pjesë.

Përdorimi i shprehjes artistike dhe lëndëve artistike për të trajtuar temat e zhvillimit të qëndrueshëm (mbrojtja e ambientit, hapësirave, rregullit, lobimi për jetë të shëndetshme

etj), është po ashtu një mundësi shumë e mirë e trajtimit të çështjeve ndërkurrikulare dhe e integritit ndërlëndor. Një ambient i shëndoshë tingullor është shumë i rëndësishëm për shoqërinë andaj trajtimi i shijes muzikore të nxënësve, kujdesi për nivelin e zërit, zhurmave etj adreson këtë çështje.

6. Udhëzimet për vlerësim

Vlerësimi në përgjithësi bëhet sipas 5 niveleve

Niveli 1 -Dëshmon një shkallë të pamjaftueshme të përmbushjes së rezultateve të të nxënit dhe përkon me vlerësimin - pamjaftueshëm.

Niveli 2- Dëshmon një zotërim minimal dhe të mjaftueshëm të rezultateve të të nxënit, por që janë bazë për veprimtarinë e nivelit pasardhës dhe përkon me vlerësimin - Mjaftueshëm.

Niveli 3 - Përfaqëson disa arritje të pjesshme të të nxënit dhe kompetenca për të kapërcyer sfidat e të nxënit dhe përkon me vlerësimin - Mirë.

Niveli 4 - Përfaqëson arritje të larta e solide në përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe përkon me vlerësimin - Shumë mirë.

Niveli 5 - Përfaqëson arritjet më të larta e të qëndrueshme në përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe përkon me vlerësimin - Shkëlqyeshëm.

Vlerësimi duhet të jetë i vazhdueshëm por mund të zbatohet edhe vlerësimi përmbledhës për periudhën dy mujore, që të vlerësohet arritja e zbatimit të planit dy-mujor. Vlerësimin e vazhdueshëm e mundëson mësimdhënësi përmes evidentimit të progresit të nxënësve me instrumente të ndryshme të vlerësimit, ku përfshihen:

- Lista e kontrollit për këngët, pjesët instrumentale dhe vlerësimi për nivelin e performimit sipas kritereve të përcaktuara;
- Testet e ndryshme muzikore (me dëgjim dhe me goje e me shkrim);
- Detyrat e ndryshme hulumtuese;
- Vlerësimi i dosjes (portofolit) të nxënësit.

Dosja e nxënësit mund të përmbajë punët/detyrat praktike që zbatohen në klasë; projekte/pune praktike si detyrë shtëpie, kolazhe CD, DVD me shembuj muzikorë, kërkime individuale për kompozitorët, instrumentet, veprat muzikore etj.

7. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mëimit të Muzikës mund të përdoren mjete didaktike dhe burime të ndryshme muzikore. Zëri dhe instrumentet tjera muzikore janë burimet kryesore për realizimin me sukses të edukatës muzikore. Pajisja e kabinetit të Muzikës me instrumente të ndryshme muzikore (ritmike dhe melodike, mundëson aktivitet muzikor dinamik në klasë dhe në shkollë. Pajisja me mjete te teknologjisë bashkëkohore TV, CD, projektor dhe qasje në internet I mundëson mësimdhënësve që të prezantojnë shembujt muzikore në klasë në

mënyrë auditive dhe vizuale, por edhe nxënësve u mundëson prezantimin e detyrave hulumtuese dhe projektet e tyre.

Tekstet mësimore, enciklopeditë muzikore e burimet online, u mundësojnë nxënësve të marrin informacione të duhura për krijuesit, instrumentet, stilet dhe zhanret muzikore, performuesit, institucionet Tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë (të këngëve dhe shembujve muzikorë për dëgjim), albume të ndryshme me pamje të instrumenteve, kompozitoreve etj mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për Muzikën. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese.

Disa burime online:

<http://music-teacher-resources.com/>

<http://www.zzounds.com/edu--musicteacherhandouts>


<http://interactivesites.weebly.com/music.html>

<http://www.classicsforkids.com/>

https://www.youtube.com/results?search_query=muzike+instrumentale+klasike

https://www.youtube.com/results?search_query=muzike+popullore+shqiptare

<https://www.youtube.com/watch?v=fABL5xSG4cA>



Programi mësimor: Matematikë

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Matematika si fushë dhe lëndë mësimore, në klasën e gjashtë siguron bazën për zhvillimin e njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave. Ajo u mundëson nxënësve të përmbushin me sukses nevojat dhe interesat e tyre, të zhvillojnë personalitetin dhe potencialin e tyre në zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e të jetës dhe integritit në shoqëri.

Nxënësit e kësaj klase vijnë nga mjediset e klasës fillore dhe me përvoja të ndryshme që lidhen me zhvillimin e të gjitha lëndëve prej një mësimdhënësi. Për këtë është e rëndësishme që programi i Matematikës dhe qasja e mësimdhënësit të sigurojë një shumëllojshmëri mundësish të të nxënësve. Kjo arrihet përmes materialeve të mira mësimore, me metodologji të larmishme të mësimdhënies, me angazhim të përhershëm për zhvillimin e aftësive të nxënësve. Tërë kjo ka synim që nxënësit të fitojnë njohuritë e nevojshme dhe të kuptojnë marrëdhëniet sasiore, hapësinore dhe modelet në fenomene të ndryshme në natyrë, shoqëri dhe në jetën e përditshme si dhe zhvillimin e të menduarit logjik, kritik, analitik dhe abstrakt.

Programi i Matematikës në vete përmban:

- Qëllimet e lëndës së Matematikës për klasën e gjashtë shërben:
 - nxënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së Matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë qytetar i suksesshëm,
 - mësimdhënësit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj,
 - prindit për njohjen e rezultateve të të nxënësve të fëmijës dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore,
 - hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësimdhënësin dhe nxënësin.
- Rezultatet e të nxënësve të lëndës për tema mësimore, për përmbajtje të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore;
- Udhëzime metodologjike të mësimdhënies si kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare për kontributin e Matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme;
- Udhëzime për vlerësimin e arritjes së nxënësve të klasës së gjashtë;
- Udhëzime për materiale didaktike, burimet dhe mjetet mësimore.

2. Qëllimi

Të mësuarit e Matematikës në klasën e gjashtë, ka për qëllim që nxënësit të fitojnë njohuri themelore matematikore të nevojshme për të kuptuar fenomenet dhe ligjet e natyrës dhe të shoqërisë, zhvillimin intelektual të nxënësve, ushtrimin e rregullave themelore, kultivimin

e vlerave si dhe përgatitjen për klasat në vijim. Po ashtu programi i Matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë dhe strukturat matematikore si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë llogaritëse dhe të zgjidhjes së problemeve në jetën e përditshme. Njëkohësisht programi i Matematikës në klasën e gjashtë gjatë zbatimit: përzgjedh dhe zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve; bën vrojtime, hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; komunikon të menduarit e tij matematik duke përdorë simbole matematike; krijon paraqitje të koncepteve të Matematikës duke i lidhur mes vete dhe i zbaton në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimi i lëndës së Matematikës në klasën gjashtë është promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të koncepteve matematike dhe përforcimin e tyre i cili bëhet përmes:

- të nxënit e integruar dhe në kontekstin e jetës së përditshme;
- të nxënit nëpërmjet përvetësimit të koncepteve elementare dhe koncepteve të ndërtuara të Matematikës.

Programi i Matematikës për klasën e gjashtë, qëllim kryesor ka krijimin e kushteve për zhvillimin e kompetencave të fushës - lëndës si dhe të kompetencave kryesore që lidhen me to.

3. Tema dhe rezultatet e të nxënit

Përvetësimi i përmbajtjeve programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante që atij i parashtrohen në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijnë aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive në arritjen e rezultateve të të nxënit të planifikuara për tema përkatëse për këtë klasë.

Në lëndën e Matematikës për klasën e gjashtë zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- Numrat, algjebra dhe funksioni
- Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria
- Përpunimi i shënimeve dhe probabilitetit

Konceptet e përgjithshme zërthehen në tema dhe për secilën temë paraqiten rezultatet e të nxënit që bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënit të fushës për shkallë.

Matematika në përmbajtjen e saj përfshin koncepte të cilat janë të mbuluara me temat përkatëse në lidhmëni me rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë për klasën e gjashtë të Arsimit të Mesëm të Lartë, dhe të harmonizuara me rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL).

Temat dhe rezultatet e të nxënit për temë:

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT-të)
<p>Numri</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zgjeron bashkësinë e numrave natyrorë në bashkësinë e numrave të plotë dhe racionalë. 2. Përdorë konceptet: numër pozitiv, numër negativ, numër i kundërt, numër reciprok. 3. Zgjeron konceptin për numrin dhe veprimet me numra nëpërmjet trajtimit më të thelluar të thyesave, numrave dhjetorë e përqindjes, demonstroi konceptin për raportet e përpjesëtimet dhe përdorë teknologjinë. 4. Përvetëson konceptin e përqindjes, mënyrën e njehsimit të saj dhe zbaton atë në praktikë në zgjidhje të problemeve. 5. Përdorë simbole, fakte dhe procedura për zgjidhjet problemore që lidhen me numra thyesorë, dhjetorë dhe demonstroi marrëdhëniet ndërmjet numrave, përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve. 6. Klasifikon numrat natyrorë, thyesorë, dhjetorë dhe krijon modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore. 7. Përdorë terminologjinë matematikore (p.sh., numër dhjetor, thyesë, përqindje etj.) për të përshkruar situata të ndryshme nga Matematika dhe nga jeta e përditshme. 8. Përvetëson Matematikën si pjesë e kulturës njerëzore (integron Matematikën me situata ose dukuri nga kontekste të tjera: jeta e përditshme, lëndët tjera, sportet, ngrohja globale, turizmi, ekonomia, ambienti, migrimi etj.). 9. Zbulon rregullat për veprimet me numra, përdor simbole dhe metoda për të modeluar marrëdhënie në situata praktike dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve. 	
	<p>Numrat natyrorë</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon 10 shifrat-simbolet për paraqitjen e numrave natyrorë, në bazë të tyre dallon sistemin numerik dhjetorë (dekad - me bazë 10), (10 njësha e bëjnë dhjetëshen, 10 dhjetëshe e bëjnë qindëshen, ...); • Shkruan dhe lexon numrat natyrorë deri në klasën e miliardave, duke i ndarë në klasa dhe përcakton vend-vlerën e secilës shifër; • Vendos numrat natyrorë në drejtëzën numerike dhe i krahason ata;

		<ul style="list-style-type: none"> • Kryen veprimet aritmetike me numra natyrorë, (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin); • Zbaton radhën e kryerjes së veprimeve themelore aritmetikore me numra natyrorë; • Përkufizon bashkësinë e numrave natyrorë si bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes dhe shumëzimit; • Dallon numrat çift e tek, të thjeshtë e të përbërë në bashkësinë e numrave natyrorë dhe formon nënbashkësi të tyre; • Përkufizon dhe zbaton kriteret e plotëpjestueshmërisë së numrave natyrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe me 10; • Modelon radhitjen e numrave duke zbuluar rregullën; • Zbërthen numrat natyrorë si prodhim i numrave të thjeshtë; • Njehson PMP (duke zbatuar algoritmin e Euklidit) dhe ShVP të dy e më shumë numrave; • Modelon barazi duke përdorur veprimet me numra natyror; • Zgjidh probleme duke përdorur veprimet me numra natyror.
	<p>Numrat thyesorë (racional)</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon thyesën si herës të dy numrave natyrorë, numëruesit dhe emëruesit; • Paraqet thyesat si pjesë të tërësisë; • Dallon llojet e thyesave, të rregullta, të parregullta dhe numrat e përzier; • Shndërron thyesat e parregullta në numra të përzier dhe anasjelltas; • Cakton pjesën e dhëna te tërësia dhe cakton tërësinë kur është dhënë pjesa; • Paraqet thyesën si masë (paraqitja e thyesave si masë i referohet pozitës së një numri në boshtin numerik); • Krahason thyesat duke shfrytëzuar drejtëzën numerike, duke i kthyer në thyesa me emërues të njëjtë dhe sipas mënyrës së shumëzimit në diagonale; • Kryen veprimet me thyesa (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin, pjesëtimin); • Zgjidh detyra me fjalë (në situata praktike) duke përdor veprimet me thyesa; • Përkufizon dhe dallon thyesat dhjetore (me emërues 10, 100, 1 000 ...);

		<ul style="list-style-type: none"> • Shndërron thyesat dhjetore në numra dhjetorë dhe anasjelltas; • Shkruan, lexon, cakton vend-vlerat e shifrave, rrumbullakon dhe krahason numrat dhjetorë; • Përdor lehtësime për shumëzim dhe pjesëtim me 10, 100, 1000 etj.; • Zbaton rregullat për kryerjen e veprimeve të mbledhjes, zbritjes, shumëzimit, pjesëtim të numrave dhjetorë; • Kryen veprimet me numra dhjetorë duke përdor kalkulatorin; • Identifikon numrat dhjetorë të fundmë, dhe të pa fundmë periodikë; • Analizon të shkruarit e numrit si thyes, si numër dhjetorë apo si përqindje për të qenë të sigurt që dallojnë vetëm në formën e të shkruarit. • Përcakton situatat jetësore se ku përdoren numrat dhjetorë , ku numrat thyesorë dhe ku përqindje • Shndërron numrat dhjetorë dhe thyesorë në përqindje; • Llogaritë përqindjen e numrave; • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke shfrytëzuar thyesat; • Modelon dhe zgjidh barazi dhe jobarazi duke përdorur numra dhjetorë dhe thyesorë.
	<p>Numrat e plotë</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon numrat e kundërt të numrave natyrorë në drejtëzën numerike; • Përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si union i bashkësisë së numrave natyrorë, numrave të kundërt të numrave natyrorë dhe numrit zero; • Përdor numrat me shenjë në situata reale (në jetën e përditshme); • Rendit elementet e bashkësisë së numrave të plotë; • Identifikon largesën e numrave të kundërt nga origjina (zeroja) në drejtëzën numerike; • Krahason numrat e plotë në drejtëzën numerike; • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke shfrytëzuar numrat e plotë; • Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes duke shfrytëzuar drejtëzën numerike.

Algjebra dhe funksioni	<ol style="list-style-type: none"> 1. Njeh marrëdhëniet në një mjedis të caktuar: krahason, klasifikon dhe rigrupon objektet duke u bazuar në një ose disa karakteristika, rendit sipas cilësive të ndryshme. 2. Kupton modelet, krijon modele të reja dhe përdor modelet në një mjedis. 3. Zbulon ligjësi, përdor kuptimin për numrin që mungon dhe përdor simbolet për të modeluar marrëdhënie në situata praktike. 4. Përdorë ekuacionet në funksion të veprimeve me numra, duke u kufizuar në mbledhje e zbritje me numra të vegjël. 5. Përvetëson funksionin që të dallojë një ligjësi, nëpërmjet modeleve konkrete, kryesisht me karakter zbavitës, me vargje. 6. Zgjeron njohuritë me koordinatat në rrjetin koordinativ. 	
	Funksioni	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon numrin që mungon në një shprehje numerike me numra natyrorë ose numra dhjetorë ose thyesa ose të kombinuara; • Vendos pikat në rrjetin koordinativ; • Dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë ose dhjetorë ose thyesa), në përshtatje me njohuritë për veprimet me numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa; • Paraqet funksionin si lidhje e dy bashkësive, me diagram, tabelë dhe si dyshe të renditura në rrjetin koordinativ.
	Shprehjet shkronjore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike; • Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave; • Modelon probleme me shprehje shkronjore; • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke shfrytëzuar shprehjet shkronjore; • Shndërrojnë shprehjet me simbole në shprehje me fjalë dhe anasjelltas.

	<p>Ekuacionet dhe inekuacionet lineare</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe zgjidhjet përkatëse të tyre; • Zgjidh ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur (duke përdorur vetitë aditive dhe multiplikative); • Paraqet zgjidhjen e inekuacioneve lineare me një të panjohur në drejtëzën numerike dhe formon bashkësinë e zgjidhjes; • Zgjidh probleme nga jeta e duke shfrytëzuar ekuacionet.
<p>Matjet</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zbaton proceset e matjes duke përzgjedh teknika dhe formula e duhura për të kryer matje. 2. Zgjeron njohuritë për matjet indirekte duke përdorur formulat. 3. Përafërsia në matje dhe parashikimi i përafërt i rezultatit kanë të bëjnë me dobinë e matjeve në situata problemore të jetës së përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Matë, krahason segmentet, konstrukton simetralen e tyre; • Përcakton raportet ndërmjet koncepteve themelore: pikë, drejtëz, rrafsh dhe koncepteve të nxjerra; • Konstrukton simetralen e segmentit, drejtëzat paralele dhe pingule (normale); • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke përdorë matjet; • Përcakton dhe përdorë njësitë matëse të gjatësisë, syprinës, vëllimit; • Njehson perimetrin e figurave (vijave të thyera) geometrike; • Njehson syprinën e sipërfaqes së drejt-këndëshit dhe katrorit; • Shndërron njësitë matëse nga njëra njësi në njësinë tjetrën; • Shfrytëzon kriterin e plotëpjestueshmërisë së numrave me katër për identifikimin e viteve të brishta në kalendarin Gregorian; • Shndërron valutat e monedhave që përdoren në vendin tonë dhe vendet tjera.
	<p>Njësitë matëse</p>	

	<p>Gjatësia, masa, koha</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor njësitë dhe mjetin e përshtatshëm për të kryer një matje në një rast konkret; • Këmben njësitë e matjes (kg me g; km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në tre shifra pas presjes; • Parashikon një veprimtari matëse deri në cm ose mm më të afërt; • Kryen vizatime dhe matje të segmenteve; • Zbaton njësitë e matjes së kohës (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada, shekulli) dhe i këmben ato; • Lexon dhe përdor sistemin 24 orësh; • Llogaritë kohën në tabelat e orareve me sistemin 24 orësh; • Përdor kalendarin për të zgjidhur situata të jetës praktike; • Llogaritë orën në zona të ndryshme të botës; • Përdor raportorin për majën e këndeve.
<p>Gjeometria (Forma dhe Hapësira)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përdor arsyetimin dhe vërtetimin për të zbuluar dhe provuar marrëdhëniet gjeometrike ndërmjet figurave 2D (2 dimensionale) dhe objekteve 3D (3 dimensionale). 2. Prezanton të dhëna empirike për figurat 2D dhe ndërton figura gjeometrike me disa elemente të dhëna 3. Paraqet, klasifikon konceptet gjeometrike (trekëndëshat dhe katërkëndëshat) dhe i zbaton në zgjidhje të problemeve në situata reale. 4. Zgjeron njohuritë për shumëkëndëshat e rregullt duke deduksione të thjeshta. 5. Trajton shndërrimet gjeometrike, simetrinë boshtore me zhvendosjen paralele dhe rrotullimin në sistemin koordinativ. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan pikën, drejtëzën dhe rrafshin, si koncepte themelore gjeometrike; • Përkufizon gjysmëdrejtëzën, segmentin dhe gjysmërrafshin si koncepte të nxjerra; • Vizaton drejtëza paralele dhe normale • Paraqet pikën si dyshe e renditur në rrafshin Oxy dhe identifikon koordinatat e pikës;
	<p>Kuptimet themelore të gjeometrisë</p>	

	<p>Figurat gjeometrike</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikon shumëkëndëshat sipas vetive të tyre; • Përkufizon këndin dhe dallon atë sipas masave (i ngushtë, i drejtë, i gjerë, i shtrirë, i hapur, i plotë); • Dallon njësitë për matje të këndeve ($0'$, $''$, radian) dhe bën shndërrimin nga një njësi në tjetrën; • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke përdorë matjet; • Cakton masën e këndeve duke përdorë këndmatësin dhe konstruktoren simetrale të këndit; • Dallon llojet e këndeve sipas pozicionit të krahëve (brinjëve) dhe masave të tyre (suplementare, komplementare); • Vizaton këndet e ngushta dhe këndet të gjera (nga 90° deri në 180°); • Llogarit dhe kontrollon shumën e këndeve të një trekëndëshi; • Përcakton shumën dhe ndryshimin e këndeve në mënyrë algjebrike dhe konstruktive; • Përkufizon trekëndëshin: elementet dhe llojet; • Klasifikon trekëndëshat sipas brinjëve dhe sipas këndeve; • Përkufizon shumëkëndëshat; • Konstruktoren: trekëndëshin barabrinjës, katrorin, drejtkëndëshin, rombin, romboidin, gjashtë-këndëshin e rregullt; • Përkufizon rrethin, elementet e tij (qendrën, rrezën, diametrin, tangjenten, sekanten) dhe sipërfaqen rrethore; • Konstruktoren rrethin kur jepet rrezja, diametri;
	<p>Trupat gjeometrik</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan trupat gjeometrikë sipas vetive të tyre; • Përkufizon trupat gjeometrikë (kubin dhe kuboidin); • Përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet); • Përcakton numrin e kulmeve, faqeve, brinjëve (teheve) (Formula e Eulerit); • Paraqet hapjen e kubit dhe kuboidit në rrafsh dhe i ndërton ato.

	Shndërrimet gjeometrike	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Lexon dhe plotëson koordinatat në rrjetin koordinativ; • Vendos koordinatat e një figure gjatë simetrisë, zhvendosjes dhe rrotullimit 90° .
	Perimetri dhe syprina	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit; • Njehson perimetrin dhe syprinën e drejtkëndëshit; • Vlerëson me anë të katrorëve syprinën e një figure jo të rregullt; • Llogarit syprinën e një figure të thjeshtë të përbërë. • Përdorë matjet dhe përvetëson formulat për caktimin dhe njësimin e gjatësisë, masës, kohës, perimetrin, syprinën e figurave dhe vëllimin e trupave si dhe zgjidhë probleme nga situata reale; • Zbaton rregullat për llogaritjen e syprinës së katrorit, drejtkëndëshit, kubit, kuboidit në shembuj të ndryshëm.
	Vëllimi	Nxënësi: Këmben njësitë matëse të vëllimit: litri dhe mililitri
Të dhënat dhe probabiliteti	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lexon, kupton dhe interpreton të dhënat statistikore (me figura të ndryshme) për të marrë vendime në jetën e përditshme. 2. Demonstron njohuritë e marra për grumbullimin dhe paraqitjen e të dhënave. 3. Interpretimi i të dhënave dhe përdorë terminologjinë matematikore (p.sh., modë, medianë, mesatare aritmetike etj.) për të përshkruar situata të ndryshme nga statistika dhe nga jeta e përditshme; 4. Përvetëson konceptet elementare të probabilitetit; 5. Përdor teknologjinë për zgjidhjen e problemeve nga statistika dhe probabiliteti dhe nga jeta e përditshme. 	
	Statistika	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Grumbullon, klasifikon, lexon, interpreton dhe paraqet të dhënat për të nxjerrë konkluzione; • Zgjidh, justifikon dhe përdor metoda të përshtatshme të mbledhjes së të dhënave, duke përfshirë: pyetësorë, eksperimente, media elektronike, etj.;

		<ul style="list-style-type: none"> • Llogaritë mesataren aritmetike, modën, medianën nga të dhënat; • Analizon rezultatet e të dhënave në probleme të ndryshëm nga jeta reale; • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke përdorë statistikën; • Përdorë teknologjinë për paraqitjen e diagrameve pas grumbullimit të të dhënave (paraqitjen e tabelave në Excel)
	<p>Probabiliteti</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Renditë dhe kombinon numrat e një bashkësie të fundme; • Përkufizon konceptin e ngjarjes; • Paraqet ngjarjet në formë numerike përmes shembujve ((p.sh hedhjen e zarit, etj)); • Përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundshme; • Përdor shprehjet: ka mundësi, nuk ka mundësi, mbase, me siguri dhe i të tjerave të ngjashme me to, në situata të jetës reale. • Identifikon të gjitha rezultatet e mundshme të një eksperimenti; • Përkufizon probabilitetin e një ngjarjes; • Krahason rezultatet eksperimentale me probabilitetin në një eksperiment; • Përkufizon konceptin e faktorielit; • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke shfrytëzuar probabilitetin.
	<p>Probabiliteti</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Renditë dhe kombinon numrat e një bashkësie të fundme; • Përkufizon konceptin e ngjarjes; • Paraqet ngjarjet në formë numerike përmes shembujve ((p.sh hedhjen e zarit, etj)); • Përcakton ngjarjet e mundshme, të sigurta dhe të pamundshme; • Përdor shprehjet: ka mundësi, nuk ka mundësi, mbase, me siguri dhe i të tjerave të ngjashme me to, në situata të jetës reale. • Identifikon të gjitha rezultatet e mundshme të një eksperimenti; • Përkufizon probabilitetin e një ngjarjes; • Krahason rezultatet eksperimentale me probabilitetin në një eksperiment; • Përkufizon konceptin e faktorielit; • Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke shfrytëzuar probabilitetin.

4. Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së Matematikës në klasën gjashtë bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë II, e cila ofron një mësimdhënie që zhvillon kompetencat e të nxënit. Temat që paraqiten në programin e klasës së gjashtë nuk zhvillohen si të veçanta, por duhet të integrohen në mes vete si dhe të jenë të lidhura me fusha të tjera. Rezultatet e të nxënit për secilën temë shërbejnë edhe për kërkesat dhe nocionet që synojnë edhe tema të tjera brenda dhe jashtë fushës kurrikulare.

Mësimdhënësi duhet të përqendrohet kryesisht në:

- Lidhjen e rezultateve të të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultateve të të nxënit për tema,
- Mësimdhënie me nxënësin në qendër;
- Mësimdhënie dhe të nxënit e integruar;
- Zhvillimin e temave ndërkurrikulare;
- Zhvillimin i veprimtarive për arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësi duhet ta ndërtojë punën e vet mbi:

- Përcaktimin e temës për t'u zhvilluar;
- Listimin e metodave, teknikave dhe strategjive të cilat bazohen në ndërveprim;
- mundësimin në qasje në të gjitha mjetet e domosdoshme që u nevojiten nxënësve, motivimin, nxitjen dhe lavdërimin e përhershëm të nxënësve;
- informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijëve të tyre.

Mësimi i Matematikës duhet të bëhet me metoda të avancuara dhe me forma moderne të punës me një qasje njohëse që përfshin zhvillimin konceptual, njohuritë dhe miratimin e skemave kuptimplote. Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, pasi i jep secilit nxënës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Nxënësit duhet të trajnohen për punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, nga se kjo jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e ri e të panjohur, të respektojnë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe punën ekipore. Përmes qasjes së nxënies me kompetenca mësimdhënësi mundëson dhe lehtëson hulumtimin dhe identifikimin e përvojave të nxënësve, të njohurive dhe pikëpamjeve të tyre, të cilat mundësojnë zhvillimin e tyre duke marr parasysh dallimet mes nxënësve në klasë.

5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngushtë me shumë komponentë të arsimit, e që njëkohësisht kontribuon në realizimin e këtyre temave: ngrohja globale, burime të përhershme e të pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit etj. Nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdorë arsyetimin matematik dhe elemente të gjuhës matematikore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në ngritjen e tij personale. Nxënësi mund të përdorë metodat statistikore si anketa, intervista për të bërë analiza rreth mendimit të njerëzve, mund të arsyetojë dhe argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin.

Duke përdor të kuptuarit për numrat, arsyetimin e raporteve, interpretimin e përqindjeve, nxënësi mund të ushtrojë gjykimin e tij kreativ dhe kritik për konsumimin dhe përdorimin e mallrave të konsumit. Njohuritë statistikore dhe probabiliteti mund të ndihmojnë nxënësin të interpretojë të dhëna për promovimin e shëndetit të mirë, traditës e zakoneve të jetesës dhe për të ushtruar gjykimin, argumentimin për vendimet e marra. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet lëndës së Matematikës është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e Matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

6. Udhëzime për vlerësim

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësve bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi, duhet të ketë parasysh rezultatet e të nxënësve për tema mësimore të klasës, duke i pasur në fokus rezultatet e fushës për shkollë. Vlerësimi i arritjes së nxënësve **të klasës së gjashtë nga Matematika** realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimeve të vazhdueshme, vëzhgimi në klasë, vlerësimit përmes testeve përmbledhëse periodike. Raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me komente konstruktive dhe me nota numerike (1-5).

Gjatë vlerësimit mësimdhënësi duhet të fokusohet dhe të mbështetet në një sasi të dhënash si: vlerësimi i përgjigjeve me gojë, puna në grup, aktivitetit gjatë debateve në klasë, detyrat e shtëpisë, testet për një grup temash të caktuara, testet në përfundim të një periudhe të caktuar, etj.

7. Udhëzime për materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimin të Matematikës mësimdhënësi jep informacione dhe performon shkathtësi duke përdor materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi gjeneron informacione dhe formon shprehje si dhe zhvillon shkathtësi duke iu qasur të mësuarit

përmes të pamurit, të dëgjuarit, prekjes, përdorimit të teknologjisë dhe formave të tjera.

Për realizimin e kompetencave të nivelit të dytë të arsimit të mesëm të ulët për klasën e gjashtë, mësimdhënësi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Mësimdhënësi, përveç materialeve dhe mjeteve të nevojshme didaktike, krijon modelime matematike, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të llojeve të ndryshme, krijon mjedis dhe klimë për aktivitete alternative. Ai po ashtu ofron edhe mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e tij në mësimin e Matematikës. Mësimdhënësi, u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë detyra dhe projekte të ndryshme.



**FUSHA
KURRIKULARE**

**SHKENCAT
NATYRORE**

Programi mësimor: Biologji

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Fusha kurrikulare Shkencat e natyrë në nivelin e II-të të shkallës III-të kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, paraqet vazhdimësinë e asaj që është arritur në nivelin e I-rë në kuadër të fushës së shkencave të natyrës si të integruara përmes lëndës mësimore Njeriu dhe natyra. Në shkallën e III-të kurrikulare, ruhet filozofia e KKK-së, që mësimi në Shkencat e natyrës realizohet në lëndët (Biologji, Kimi dhe Fizikë), duke ruajtur qasjen integruese ndërlëndore. Integrimi i lëndëve mësimore realizohet përmes koncepteve – të fushës së shkencave. Konceptet paraqesin referencën për përcaktimin e temave mësimore. Nga kjo kuptojmë së një koncept i caktuar i fushës së shkencave natyrore nuk përkufizohet vetëm për një lëndë mësimore.

Lënda mësimore, Biologjia 6, bazë referimi ka konceptin e fushës kurrikulare - Bota e gjallë. Programi i lëndës mësimore - Biologjia 6, krahas kërkesës për arritjen e rezultateve të të nxëniet për fushë (RNF-ve), mundëson edhe në kontribuimin e arritjes së rezultateve të kompetencave, të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë (KB-në), të shkallës së III-të kurrikulare.

Programi i lëndës mësimore, Biologjia 6, është hartuar sipas konceptit të KKK-së, me shtrirja programore në drejtim vertikal (klasa 1 - 12), dhe me shtrirje horizontale/ndërlidhje me fushat tjera kurrikulare, në harmoni të zhvillimit të nxënësit/ës.

Programi, Biologjia 6 - përmban rezultate të të nxëniet për lëndë (RNL), sipas temave:

- Biodiversiteti
- Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor
- Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut

Detyrë e mësimimit të Biologjisë është: zhvillimi i aftësive vrojtuese dhe të menduarit kritik që në realitet është një formë e sofistikuar e të menduarit, përkatësisht proces njohës, veprues dhe ndërveprues, përdorimit të mjeteve teknologjike gjatë hulumtimit shkencor.

Baza e lëndës mësimore Biologjia 6, qëndron në shpjegimin e biodiversitetit të botës së gjallë, marrëdhënieve mes qenieve të gjalla, përshtatshmërisë ndaj kushteve të ambientit si dhe ruajtjes së shëndetit personal të nxënësit/ës, menaxhimit të sjelljeve, emocioneve dhe të kuptuarit drejtë zhvillimit seksual.

Zhvillimi i programit mësimor të lëndës së Biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një ecurie të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, parashtrimi i rezultateve të të nxëniet për kompetenca, rezultateve të të nxëniet të fushës së shkencave natyrore si dhe përzgjedhja e metodave dhe instrumenteve të qëndrueshëm për vlerësim.

2. Qëllimi

Biologjia 6, ka për qëllim zhvillimin e kompetencave të nxënësit/ës, duke gërshetuar të nxëniet teorik me metodat e hulumtimit (vrojtimit të drejtpërdrejtë të eksperimenteve në laborator

ose në terren, burimeve të ndryshme mësimore, përpunimit të informatave, prezantimit të gjeturave, etj.). Kjo i mundëson nxënësit/ës që aktivisht të zhvilloj kompetencat e tij/saj dhe në saje të kërkimeve të gjenerojë informacione, kupton, shpjegon dhe ndikon në ndërlidhjen e jetës me natyrën.

Nxënësi/ja, përmes informatave të shumta, hulumton thelbin e problemit, zhvillon të menduarit kritik, dhe zbaton shkathtësi praktike në përpunim, analizim, argumentim dhe prezantim.

Programi mësimor i lëndës së Biologjisë për klasën e 6 -të i/e mundëson dhe ndihmon nxënësin/ën në sintezën e komponentëve të kompetencave, si në:

- **Njohjen** dhe të **kuptuarit e** termave dhe ligjshmërive shkencore;
- **Aftësive** për të shpjeguar, krahasuar dhe vlerësuar biodiversitetin;
- **Shkathtësive** për të zbatuar parimet e biosistematikës;
- **Zotësive** për shpjegimin, analizimin dhe ndikimin pozitiv në jetën e qenieve të gjalla;
- **Qëndrimin** përgjegjës gjatë punës eksperimentuese në laborator dhe natyrë;
- **Shkathtësive** për të konsultuar literaturë adekuate, në mbledhjen e informatave shkencore në mënyrë të pavarur, gjatë klasifikimit të materialit burimor shkencor, gjatë promovimit të **vlerave** për një jetë të shëndetshme;
- **Motivimit** për përdorim të aparate dhe instrumente teknologjike, për mësim tërëjetësor.

Të gjitha këto aftësi, shkathtësi, qëndrime, vlera dhe motivime, arrihen duke punuar në drejtim të arritjes së rezultateve të kompetencave për shkallën III-të kurrikulare.

3. Temat dhe rezultatet e të nxënit

Përmbajtja e lëndës është organizuar sipas koncepteve, temave dhe rezultateve të të nxënit lëndore (RNL) në përputhje me qëllimet e përgjithshme të lëndës.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës së Biologjisë së kl. 6, me konceptin bazë “Bota e gjallë” është zbërthyer në tema mësimore, me anë të të cilave përfshihet fundamenti i fushës së shkencave. Pra është hartuar mbi bazën e asaj se çfarë parashihet koncepti i caktuar duke e balansuar me rezultatet e të nxënit për fushë(RNF-ve) përmes temave (përmbledhje përmbajtjesore – njësive mësimore). Temat, janë zbërthyer në rezultate të të nxënit, të përgjithësuara, e që në fakt paraqesin rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore (RNL). Koncepti filozofik i KKK-së, që shkolla respektivisht mësimdhënësi, të kenë autonomi dhe fleksibilitet në zhvillimin dhe hartimin e programeve mësimore, bazuar në kornizën e paraparë me Kurrikulën Bërthamë (KB) si dhe programit mësimor i hartuar dhe miratuar nga MASHT, mundësohet me angazhimin dhe bashkëpunimin e mësimdhënësve brenda shkolle. Mësimdhënësi për zgjedh burime mësimore të ndryshme, përzgjedh njësi mësimore dhe harton rezultatet e të nxënit për njësi mësimore (RNJM), të cilat mundësojnë arritjen e rezultateve lëndore.

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Bota e gjallë	Biodiversiteti	<p>RNF</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbi-jetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut; • Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ush-trimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut; <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon konceptin, Biologjia – Shkencë natyrore. • Përshkruan organizimin shkallë –shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi organi, sistemi i organeve , organizmi (individ), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemi, dhe biosfera. • Identifikon rregullat themelore të emërtimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike, të qenieve të gjalla. • Njih se klasifikimi i qenieve të gjalla në grupet kryesore taksonomike na mundëson të kuptojmë biodiversitetin rreth nesh. • Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdorë këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët- arthropodat- insektet; vertebrorët- gjitarët- primatë; bimët me fare- bimët me lule- bimët barishtore). • Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë llojllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe pejzazhit fizik që i mbështet ato.

		<ul style="list-style-type: none"> • Njih rëndësinë e biodiversitetit për stabilitetin e ekosistemeve natyrore dhe përfitimet e njeriut nga biodiversiteti (sigurimin e resurseve jetësore si ushqimi, barnat, lëndët e para për prodhime të ndryshme etj.) • Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe zhdukjes së disa bimëve ose shtazëve (p.sh. për shkak të gjuetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invasive, ndryshimeve dhe shkatërrimeve të habitatit). • Identifikon produktet e jetës së përditëshme të cilat kanë origjinë nga diversiteti I organizmave (p.sh. mëndafshi nga krimbi I mëndafshit, suplementët ushqimor, shampionët, pastat e dhëmbëve dhe dezodorantët përmbajnë polen të mbledhur nga bletët etj.). • Tregon vetëdijësim që bakteret mund të kenë efekte të dobishme dhe të dëmshme për organizmin (bakteret në traktin digjektiv mund të ndihmojnë tretjen ose të shkaktojnë sëmundje.) • Identifikon bimët dhe shtazëtendemike, të rrezikuara për zhdukje, që jetojnë në Kosovë. • Identifikon mënyra për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë. • Vlerëson rolin dhe ndikimin e njeriut në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit-nivel global. • Përdorë çelësa të thjeshtë dikotomik për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë. • Analizon një çështje lokale të lidhur me biodiversitetin (p.sh. efektet e aktiviteteve të njeriut në biodiversitetin urban); • Vlerëson përfitimet që ka shoqëria njerëzore nga biodiversiteti si dhe problemet që shkaktohen nga zvogëlimi i biodiversitetit • Ndjekë rregullat e sigurisë gjatë aktiviteteve në natyrë dhe punës në terren.
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkollë, park qyteti, kënetë, lum, pyll, livadh, etj,) dhe i klasifikojnë organizmat sipas sistemit të klasifikimit. • Krahason karaktersistikat e organizmave brenda mbretërive të bimëve ose shtazëve (p.sh. krahasojnë karakteristikat e nje peshku dhe një gjitari, të një peme gjethëmbajtëse-halore dhe nje peme gjethërënëse, të fiernave dhe bimëve me lule) . • Përdor fjalor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësia jetësore natyrore (biocenoza) , marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët-kurrizorët, invertebrorët-parruazorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmi etj. • Shfrytëzon organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.
	<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e ekosistemit. • Definon nocionet/termat themelore ekologjike. • Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi- karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit- tipet e organizmave tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit). • Diskuton efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes). • Përshkruan se si përshtatjet shërbejnë për të mundësuar mbijetesën dhe ato mund të jenë strukturale dhe të bazuara në sjelljesigurimi i ushqimit, strehimi, ikja nga grabitqari, riprodhimi duke gjetur ose tërhequr partnerin ose shpërndarja e farave/fryteve. • Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesëve, konsumuesëve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rrjetën e ushqimit.

		<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan shndërrimin e energjisë së dritës në energji kimike gjatë krijimit të lëndëve ushqyese në shembullin e fotosintezës duke mos u shërbyer me simbole kimike në pasqyrimin e ekuacionit të fotosintezë • Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zbrërthimit të lëndëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit duke shpjeguar nocionet prodhuesit dhe konsumuesit. • Bënë dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.-Organizmi është qenie e gjallë.- Popullata definohet si grup I bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar.-Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë. • Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshti, livadhi, pema, kënetë, përroi etj.). • Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim). • Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh. ujqit udhëtojnë në grup për të mbrojtur territorin e tyre, rrisin të vegjëlit (këlyshët) e tyre dhe gjuajnë prenë e madhe). • Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm duke pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegojnë se si këto marrëdhënie mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit. • Krahason dhe bëjnë dallimin mes ekosistemeve natyrore dhe artificiale.
--	--	---

		<ul style="list-style-type: none"> • Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ) . Ndikimi pozitiv: p.sh. Ruajtja-konservim i biodiversitetit, pyllëzimi; Ndikimi negative: p.sh. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi , ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale • Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.
	<p>Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon çfarë është puberteti dhe çfarë ndryshimesh sjell në organizmin e njeriut.. • Vlerëson rolin e higjienës së organeve seksuale, posaçërisht te moshat të cilës i takojnë vetë nxënësit. • Përshkruan rëndësinë e mbajtjes së rregullt të higjienës personale për ruajtjen e shëndetit me theks të kujdesit për higjienën personale gjatë pubertetit. • Dallon të ushqyerit e rregullt nga të ushqyerit jo të rregullt dhe kupton rëndësinë e të ushqyerit të rregullt për shëndetin. • Zbaton aktivitetin e rregullt trupor në përputhje me moshën e tij, afinitetet dhe gjendjen shëndetësore. • Organizon drejtë kohën për punë dhe pushim gjatë ditës. • Përshkruan pasojat e gjumit të pamjafueshëm dhe lodhjes dhe debaton për to, dhe njih shenjat e qëndrimit të tepruar para ekranit ose kompjuterit. • Përshkruan rëndësinë e ruajtjes së shëndetit riprodhues dhe flet për shëndetin riprodhues me prindërit, dhe përshkruan ku dhe si të kërkoj ndihmën profesionale mjekësore.

4. Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të programit mësimor sipas planifikimit mësimor për shkencat natyrore- Biologjia 6, si gjatë realizimit të orës mësimore ashtu dhe jashtë orës mësimore, si gjatë realizimit të aktiviteteve kurrikulare ashtu dhe aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive të ndryshme të harmonizuara me rezultatet e pritshme dhe në kontekst të qëllimeve dhe parimeve të KKK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësit, me natyrën e përmbajtjes së njësive mësimore gjegjësisht me kërkesat e rezultateve të pritura të të nxënësit për orë mësimore apo aktivitete mësimor, në harmoni me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësit/ës dhe kompetencat e synuara.

Shkencat e natyrës zhvillohen përmes hulumtimit dhe eksperimentit, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur, të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësin/ën, kurse arsimtari të ketë rol udhëheqës.

Suksesi i nxënësit/ës në lëndët e shkencave të natyrës varet jo vetëm nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit por edhe nga motivimi, përfshirja, ngritja e hipotezave dhe angazhimi i vetë nxënësit/ës. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejt (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Mësimdhënie dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie dhe të nxënësit që nxit hulumtimin e pavarur;
- Mësimdhënie dhe të nxënësit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Format e punës

- individuale
- në çifte
- në grupe të vogla
- me të gjithë nxënësit

Mësimdhënësi udhëheq nxënësin/ën ashtu që ai/ajo me aktivitetet e tij/saj në: klasë, shkollë, laborator, natyrë dhe në jetën e përditshme, aftësohet të: njoh, kuptoj, vrojtoj, krahasoj, klasifikoj, bën matje, mban shënime, mbledh të dhëna, eksperimenton, mbikëqyr procedura, mendon në mënyrë të pavarur, mbron dhe argumenton mendimet e veta.

Nxënësi/ja, sillet sipas parimeve didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.

5. Udhëzime për çështje ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lëndë. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare (mësimore) dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritshmërisë së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimit për paqe, të drejtat e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit, edukimin për karrierë dhe aftësitë për jetë.

Si realizohen çështjet ndërkurrikulare?

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në kurrikulë nëpërmjet temave dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën shkollore të Shkencave natyrore , për këtë shkallë kurrikulare gjegjësisht për klasën 6-të, janë:

- Edukimi për media
- Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm

Edukimi për media - i referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja, të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtje lidhur me publikimet shkencore, shpërblimet për të arriturat në shkencë qoftë në nivelin kombëtar apo ndërkombëtar. Po ashtu duhet të përfshijë edhe përparësitë, mangësitë dhe rreziqet e mesazheve (informatave) të medieve, duke pasur edhe qëndrim kritik ndaj në rast të manipulimit të medieve dhe duke vepruar gjithmonë në përdorimin e tyre (medieve) për të vepruar në shërbim të mirës publike.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësit, për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve për mjedisin, në vetëdijësimin e tyre duke rritur ndjenjën e përgjegjësisë ndaj mjedisit natyror dhe atij të bërë nga dora e njeriut, në ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global.

Këtu hyjnë çështjet si: aspekti social, zhvillimi ekonomik, mjedisi i shëndetshëm, kapaciteti për t'u përballur me katastrofat natyrore dhe ato të krijuara nga dora e njeriut, shfrytëzimi i

burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

6. Udhëzime për vlerësim

Zbatimi i programit mësimor, është i pamundur pa komponentin e vlerësimit të nxënësit. Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësit/ës gjatë procesit të të nxënës dhe nxjerrja e gjykimit për ato arritje.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësit/es dhe motivimit të tij/saj për të nxënë;
- Vlerësimi i punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënës;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësit/ës gjatë procesit të të nxënës;
- Vetëvlerësimit të nxënësit/ës;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga qasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA (lexo UA) i bazuar në kërkesat e KKK-së.

Vlerësimi i brendshëm - Vlerësimi i brendshëm bëhet në nivel klase nga mësimdhënësi/et e lëndëve mësimore përkatëse dhe sipas përshkrimit të procedurave e kriterëve për secilin lloj të vlerësimit të brendshëm, të rregulluara me akte nënligjore.

Fokusi kryesor i vlerësimit të brendshëm është mbështetja e të nxënësve të nxënësve për zotërimin e kompetencave të shkallëve të caktuara. Kjo arrihet duke kombinuar vlerësimin formativ (për nxënie) me vlerësimin përmbledhës (i të nxënës).

Llojet e vlerësimit të brendshëm

Korniza e Kurrikulës përcakton tri lloje të vlerësimit të brendshëm të cilat janë të vlefshëm edhe për realizimin e KB:

- Vlerësimi i vazhdueshëm
- Vlerësimi përfundimtar
- Vlerësimi për shkallë

Vlerësimi i vazhdueshëm përfshin:

1. Vlerësimin formativ (vlerësimi për të nxënë)
2. Vlerësimin përmbledhës (vlerësimi i të nxënës)

1. Vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë) kryhet në mënyrë të vazhdueshme për

marrjen e informacioneve të arritjeve të nxënësve gjatë çdo veprimtarie mësimore, me qëllim të përkrahjes së nxënësve.

- 1.1 Vlerësimi diagnostikues - përdoret për marrjen e informacioneve të arritjes së nxënësit për shkallën e përvetësimit të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave dhe i ndihmon mësimdhënësit në punën e mëtejshme.
- 1.2 Vlerësimi motivues - përdoret për nxitjen e interesimit dhe dëshirën e nxënësit/ës për të nxënë.

Përmes vlerësimit formativ (vlerësimi për të nxënë), mësimdhënësi/ja vlerëson, mbikëqyrë përparimin e nxënësit/es gjatë procesit të të nxënës, mbledhë informacion për marrjen e vendimeve për të ofruar mbështetje të nevojshme për të nxënësit e nxënësit/ës.

2. Ndërsa, me ndihmën e vlerësimit përmbledhës (vlerësimi i të nxënësit), mësimdhënësi/vlerësuesi përcakton arritjet e nxënësit në përfundim të një detyre të caktuar, teme mësimore, kapitulli, periudhe mësimore etj., për të vendosur notat dhe për të vlerësuar nxënësin/ën për nxënie të mëtejshme. Vlerësimi përmbledhës përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e të nxënësit ose të programit mësimor. Në këtë kontekst p.sh në lëndën e Biologjisë, në fund të çdo detyrës (periudhë të cilën e përcakton mësimdhënësi; një mujore, detyrë, tremujore), mund të organizohen procedura vlerësimit për pjesë të ndryshme të lëndës për të parë sa kanë nxënë ose sa kanë zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e ndryshme në lëndën e Biologjisë.

Vlerësimi përmbledhës bëhet me notë, duke përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme vlerësimi si: përgjigjet me gojë, me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, vetëvlerësimi, teste, etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësit. Mësimdhënësi/ja është i/e pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësit/ës, prindërve dhe komunitetit.

Vlerësimi përfundimtar:

- 1 Përfshin vlerësimin në fund të çdo periudhe mësimore e përcaktuar me kalendarin shkollor, sipas MASHT-it (përfundimi i tremujorit të I-rë, II-të dhe III-të). Vlerësimi përfundimtar nënkupton përmbledhjen e vlerësimeve përmbledhëse brenda një tremujori.
- 2 Vlerësim përfundimtar, quhet dhe vlerësimi i cili realizohet në fund të vitit shkollor, që nënkupton përmbledhjen e tre tremujorëve të paraparë me kalendarin shkollor, i miratuar nga MASHT-i.
 - Vlerësimi për shkallë – realizohet në fund të shkallës kurrikulare.

Mësimdhënësit/et e shkencave natyrore – Biologjia 6, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumente të vlerësimit, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard, të jetë i specifikuar bazuar në kritere, i hartuar nga vetë mësimdhënësit/et, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës brenda kornizave të planit vlerësues nivel DKA-ve dhe UA i miratuar nga MASHT-i.

Gjykuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësime/ndërmësimi/ ja vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim, rishikim të kriterëve të përdorura gjatë vlerësimit, të rizgjedhë instrumente të vlerësimit, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësime/ndërmësimi/ ja harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësit/ës, i cili plan duhet të miratohet nga të gjitha grupet e interesit (aktiviteti profesional, drejtorja e shkollës, nxënësi/ ja dhe prindërit) të jetë transparent dhe të ju shpërndahet gjitha palëve të interesuara.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:

- Vlerësimi me shkrim
- Vlerësimi me gojë
- Vlerësimi me anë të dëgjimit
- Vlerësimi praktik
- Vlerësimi me anë të pyetësorëve
- Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në teren
- Testimi - është ecuria e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të testeve, si:

- Testet me përgjigje alternative
- Testet me kombinime
- Testet me alternativa të shumta
- Testet me përgjigje të shkurtra dhe me plotësim.

Vlerësimi duhet të jetë:

- I vlefshëm
- I besueshëm
- I paanshëm

7. Materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të programit Biologjia 6, është e nevojshme të shfrytëzohen materiale dhe mjete të ndryshme mësimore, në mjedis të përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;

- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale - pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

Programi mësimor: Fizikë**Përmbajtja**

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektual dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike dhe natyrore përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve. Mësimi i shkencave natyrore i ofron nxënësit mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, e praktikave më të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, e kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme. Kurrikula e shkencës ndihmon në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social dhe ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon fusha e shkencave të natyrës në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyçe, në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi fillon me idetë e tij se si janë gjërat dhe pastaj i ndryshon dhe i zhvillon duke i provuar ato praktikisht. Gjatë veprimtarive shkencore nxënësi ndeshet me mundësitë e ndryshimit, rivendosjes ose sfidës së ideve. Kjo mënyrë e të nxënit bën që nxënësi të zhvillojë dhe formojë të kuptuarit shkencor përmes ideve dhe përvojave të tij

Lënda e Fizikës që do të mësohet në klasën VI përfshin njësitë mësimore më të kondenzuara, por gjithnjë duke pasur parasysh aftësitë psike-fizike të nxënësve. Nëpërmjet lëndës së Fizikës nxënësit njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e dukurive të natyrës.

Fusha kurrikulare Shkencat e natyrës në shkallën e III kurrikulare paraqet vazhdimësinë e asaj që është arritur në kuadër të fushës së shkencave të natyrës, si të integruara në ëndën mësimore "Njeriu dhe natyra".

Në shkallën e III kurrikulare, përsëri ruhet integrimi, ani pse mësimdhënia organizohet në lëndë mësimore (Biologji, Kimi dhe Fizikë) Lënda mësimore, Fizika 6, më së shumti kontribuon në konceptin e fushës kurrikulare - „ proceset fizike” por edhe në konceptet tjera. Pikë referimi për lëndën Fizika 6, paraqesin rezultatet e të nxënit të kompetencave dhe rezultatet e të nxënit të fushës -.Përmes mësimit të Fizikës , kontribuojmë që nxënësi të arrij kompetencat e synuara sipas Kurrikulës Bërthamë te kësaj shkalle. Rezultatet lëndore, pika referente kanë temat: Metodatat e hulumtimit,zbatimi i shkencës dhe i teknologjisë ne proceset fizike te lëvizjet, bashkëveprimet, energjitë mekanike, termike, strukturën e lendes, dukurive elektromagnetike dhe optike

2. Qëllimi

Qëllimet e të mësuarit të lëndës së Fizikës janë:

- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e koncepteve shkencore dhe teknologjike përmes eksplorimit të proceseve njerëzore, natyrore dhe fizike në mjedis;
- Zhvillimi i qasjes shkencore në zgjidhjen e problemeve e cila ndihmon të kuptuarit dhe të menduarit kritik e krijues;
- Inkurajimi i nxënësve të eksplorojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë idetë dhe konceptet shkencore përmes dizajnit dhe aktiviteteve praktike;
- Inkurajimi i nxënësve të vlerësojnë kontributin e shkencës dhe teknologjisë në mjekësi, ekonomi, kulturë dhe dimensione të tjera në shoqëri;

- Kultivimi i kujdesit dhe respektit për diversitetin e qenieve të gjalla dhe jo të gjalla, varësinë dhe bashkëveprimin mes tyre;
- Inkurajimi i nxënësve të sillen me përgjegjësi për të mbrojtur, përmirësuar dhe dashur mjedisin duke u involvuar në identifikimin, diskutimet dhe aktivitetet për problemet mjedisore që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Gatishmëria e nxënësve të komunikojnë idetë, prezantojnë punën dhe raportojnë të gjeturat e hulumtimeve përmes medieve të ndryshme;
- Zotërimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve në shkencë.

•

3. Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e gjashtë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës, të shkallës së tretë të kurrikulës (Shk 3) në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët:

Koncepti / Domeni : I.Lëvizja; II.Struktura e lendes; III.Bashkëveprimi; IV.Energjia.

Proceset Fizike	Tërësitë tematike	Rezultatet e të nxënit.
	<p>Lënda e studimit të Fizikës, madhësitë themelore, trupat dhe sistemet</p>	<p>II.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon dukuri natyrore të cilat janë fushë e studimit të lëndës së fizikës, lëndës së kimisë, lëndës së Biologjisë, lëndës së Astronomisë dhe lëndës së Gjeografisë; • Dallon trupat dhe objektet në natyrë sipas vetive themelore; • Vlerëson masën, vëllimin dhe densitetin e trupit si veti karakteristike të përcaktimit të tij; • Identifikon gjatësinë, kohën dhe masën e trupit si madhësi themelore në fizikë; • Përkufizon sistemin si tërësi pjesësh që punojnë së bashku dhe në harmoni; • Përshkruan sistemin diellor si sistem të përbërë nga Dielli, planetët dhe trupat e vegjël; • Tregon sisteme themelore të ndërtimit të bimëve, kafshëve dhe njeriut. • Demonstron eksperimentalisht punën e qarkut elektrik si sistem, dhe përshkruan sisteme tjera të ndërtuara nga njeriu; • Zgjidh detyra numerike për përcaktimin e masës, vëllimit dhe densitetit të trupit, kur dy prej tyre janë të njohura;

	<p>Proceset në natyrë dhe matjet themelore.</p>	<p>II</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerëson ndërrimet që shkaktohen nga natyra dhe nga njeriu; • Dallon ndërrimet fizike, ndërrimet kimike dhe ndërrimet biologjike të trupave në natyrë. • Paraqet shembuj të proceseve të kthyeshme dhe proceseve të pakthyeshme në natyrë (Fizikë, Kimi dhe Biologji); • Tregon shembuj të proceseve ciklike të lëndës dhe trupave në natyrë (Fizikë, Kimi, Biologji dhe Gjeografi), dhe të riciklimit nga njeriu; • përshkruan matjen si krahasim me një standard të paracaktuar; • Demonstron eksperimentalisht matjen e masës, matjen e gjatësisë dhe matjen e kohës me ndihmën e veglërive gjegjëse; • Demonstron eksperimentalisht përcaktimin e densitetit të trupit me formë të pa rregullt; • Demonstron eksperimentalisht matjen e të njëjtës madhësi themelore disa herë dhe arrin deri te përkufizimi i vlerës mesatare të saj;
	<p>Lëvizja dhe bashkëveprimet</p>	<p>I dhe III</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon lëvizjen e trupit si ndërrim të pozitës së tij ndaj një sistemi referimi në hapësirë dhe kohë; • Demonstron eksperimentalisht kuptimin e shpejtësisë mesatare, dhe shqyrton lëvizjen e njëtrajtshme drejtvizore të trupit; • Identifikon forcën si madhësi fizike të bashkëveprimit, ndryshimit të shpejtësisë dhe drejtimit të lëvizjes; • Identifikon shembuj për bashkëveprimet, gravitacionale, elektrike dhe magnetike si bashkëveprime në distancë dhe bashkëveprime me takim; • Demonstron eksperimentalisht me shembuj, peshën e trupit si forcë të veprimit të tij mbi bazë, respektivisht në pikën e varjes, kurse masën si rezistencë ndaj ndryshimit të gjendjes së lëvizjes; • Demonstron eksperimentalisht forcën e rëndesës, forcën e fërkimit dhe forcën elastike;

		<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron eksperimentalisht shtypjen, tërheqjen, ngritjen dhe deformimet e trupave si lloje të bashkëveprimeve; • Demonstron eksperimentalisht matjen e masës dhe matjen e peshës me vegëlërinë përkatëse; • Demonstron eksperimentalisht bashkëveprimet e forcave paralele, me kahe të kundërta dhe kur mbyllin kënd të drejtë në mes veti; • Zgjidhë detyra numerike për përcaktimin e rrugës së trupit, kohës së lëvizjes, vlerës mesatare, dhe veprimeve me forca;
	Shtypja dhe rrjedhja	<p>I dhe III</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon shtypjen si herës në mes të forcës dhe sipërfaqes së veprimit; • Përshkruan vetitë themelore të shtresave të atmosferës dhe lëvizjet e ajrit nga temperatura; • Demonstron eksperimentalisht vertetime për paraqitjen e shtypjes atmosferike; • Demonstron eksperimentalisht përhapjen e shtypjes në lëngje; • Trajton lëvizjen e fluidit si rrjedhojë të shkaktuar nga ndryshimi i shtypjes; • Zgjidhë detyra numerike për përcaktimin shtypjes, forcës apo sipërfaqes së veprimit;
	Energjia, puna, fuqia dhe makinat e thjeshta.	<p>IV</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon trajta të ndryshme të energjisë si: mekanike, elektrike, të brendshme, kimike dhe biologjike; • Përshkruan llojet e energjive mekanike dhe paraqet shprehjet e tyre; • Identifikon elektricitetin si bartës të energjisë. • Tregon shfrytëzimin e energjisë, kimike dhe biologjike në jetën e përditshme; • Shpjegon energjinë si madhësi konstante të një trupi a sistemi dhe shndërrimet e saj; • Identifikon punën si mekanizëm për transferimin e energjisë mekanike; • Përkufizon fuqinë si raport në mes energjisë së transferuar dhe kohës së transferimit; • Dallon energjinë diellore si burimin kryesor të energjisë në Tokë;

		<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon energjinë si veti e trupit a sistemit, e cila mund të shkaktojë ndryshime; • Vlerëson përparësitë e burimeve të energjisë së pastër ndaj burimeve të energjisë së djegies së fosileve dhe lidhjen e shfrytëzimit të tyre me ndotjen e mjedisit; • Ilustron parimin e punës së makinave të thjeshta; • Demonstron eksperimentalisht punën me makina të thjeshta; • Zgjidhë detyra numerike për energjitë mekanike, punë dhe fuqi;
	Dukuritë termike.	<p>II dhe IV.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ndërtimin grimcor të lëndës; • Përkufizon energjinë e brendshme të trupit / sistemit dhe tregon mënyrat e ndërrimit të saj; • Interpretton temperaturën si vlerësim të energjisë së brendshme të trupit / sistemit; • Përkufizon temperaturën si shkallë e energjisë së lëvizjes së grimcave përbërëse të trupit/ sistemit; • Interpretton nxehtësinë si mekanizëm për transferimin e energjisë së brendshme; • Demonstron eksperimentalisht matjen e temperaturës së atmosferës me termometër dhe përshkruan punën e termometrit mjekësorë; • Demonstron eksperimentalisht rregullën e Richmanit për dy apo më shumë sisteme me nxehtësi të Ndryshme; • Përshkruan ndërrimet e vetive fizike të trupave të shkaktuara nga nxehtësia; • Identifikon tri llojet e këmbimit të nxehtësisë: përçimi, rrymimi dhe rrezatimi; • Tregon punën e makinave të thjeshta termike dhe vlerëson rendimentin e tyre;
	Ngarkesat, rrymat dhe magnetet e përhershme	<p>II dhe III.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon paraqitjen e elektriciteteve të kundërta duke u bazuar në strukturën e ndërtimit të lëndës; • Tregon mënyrat e mundshme të ngarkimit të trupave me elektricitet; • Demonstron eksperimentalisht vetitë elektrike të trupave dhe ndarjen e tyre në përçues dhe veçues;

		<ul style="list-style-type: none"> • Demonstron eksperimentalisht paraqitjen e rrymës elektrike si lëvizje të ngarkesave në përçues; • Identifikon burimet e rrymës elektrike dhe shpenzuesit e llojeve të ndryshme; • Demonstron eksperimentalisht qarkun elektrik me një, dy apo tri burime dhe me një, dy apo tre shpenzues dhe nxjerr përfundimet për lidhje të burimeve dhe rezistorëve; • Përshkruan veprimet e rrymës elektrike:- magnetik, termik, kimik, optik dhe fiziologjik; • Identifikon forma të ndryshme të magneteve të përhershme dhe dallon magnetet e përhershme nga magnetet e rrymës elektrike; • Demonstron eksperimentalisht dhe liston trupat që ndejnë ndikimin e magneteve të përhershme;
	<p>Përhapja drejtvizore e dritës</p>	<p>IV.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon burime të ndryshme të dritës dhe dallon sipërfaqet ndriçuese (shkëlqimi) nga sipërfaqet që e reflektojnë dritën (ndriçimi); • Vërteton me shembuj, përhapjen drejtvizore të dritës, me krijimin e hijes dhe gjysmëhijes dhe me eklipsin e Hënës dhe Diellit; • Demonstron eksperimentalisht ligjin e reflektimit dhe ligjin e thyerjes së rrezeve të dritës; • Përcakton me vizatim pozitën e shëmbëllimit në pasqyra të rrafshëta dhe shpjegon karakteristikat themelore në to; • Përshkruan instrumentet e thjeshta optike (pasqyrat, thjerrat) dhe interpreton shëmbëllimet e fituara nga to; • Demonstron eksperimentalisht ngjyrat themelore përbërëse të dritës së bardhë pas përhapjes së saj nëpër prizëm optik (dispersioni).

4. Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore- Fizike, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare po ashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KKK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj

Shkencat e natyrës janë shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejt (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Në lenden e Fizikës, kërkimi shkencor është baza e kompetencave. Metodrat që mund të përdorin në lëndën e Fizikës janë:

- vëzhgimin
- metodat eksperimentale dhe empirike
- formimin e një ideje (hipotezës)
- përdorimin e TIK-ut.

Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

Metoda e vëzhgimi - është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi.

Metoda eksperimentale - fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshme sasiore dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

Projektet - janë veprimtari të nxëni nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

TIK Teknologjia e informacionit mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënit të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë

Format e punës

- individuale
- në çifte
- në grupe të vogla
- me të gjithë nxënësit

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: **prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.**

5. Udhëzime për çështjet ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për medie
- Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për medie - i referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për medie përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlihet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të të nxënësve. Ai mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësi. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle. Vlerësimi ka këto qëllime kryesore: përkrahjen dhe forcimin e të nxënësve, raportimin e rregullt të përparimit individual të nxënësve, përmbushjen me sukses të kompetencave të përcaktuara në kurrikulë, dhe vendosjen dhe monitorimin e standardeve të arritshmërisë për çdo nivel.

Vlerësimi u shërben shumë qëllimeve, prandaj është e rëndësishme që mësuesi t'ia përshtatë llojin e vlerësimit qëllimit specifik të synuar. Para marrjes së një gjykimi në lidhje me një aspekt të caktuar të performancës së nxënësve, mësuesi duhet të sigurojë që mënyra e vlerësimit të përdorur të sigurojë informacionin që reflekton saktësisht një aspekt të veçantë të performancës që ka për qëllim të vlerësojë.

Është thelbësore që vlerësimi të jetë pjesë e procesit të mësimit dhe të nxënësve. I gjithë procesi i të nxënësve në shkencat e natyrës mbështetet në kërkimin shkencor, dhe si i tillë, edhe vlerësimi merr shumë forma:

- Vlerësimi diagnostikues zakonisht kryhet në fillim të shkollës apo të vitit shkollor, për të identifikuar njohuritë paraprake, interesat, ose aftësitë që kanë nxënësit rreth qëllimit për të cilin po kryhet vlerësimi;
- Duke qenë pjesë e procesit të të nxënësve vlerësimi formues përdoret në të gjitha shkallët. Vlerësimi formues u shërben nxënësve për të përmirësuar të nxënësve, dhe mësuesit për të përmirësuar metodat e mësimit;
- Vlerësimi përmbledhës përdoret për të përcaktuar shkallën në të cilën janë arritur kompetencat. Ai shërben jo vetëm për të informuar nxënësit dhe prindërit për progresin e tyre, por edhe për të përmirësuar praktikën e mësimit dhe të nxënësve. Vlerësimi përmbledhës bëhet me notë, duke përdorur metoda dhe instrumenta të ndryshëm vlerësimi si: përgjigjet me gojë, me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, vetëvlerësimi, teste, etj.; Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve.

Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave, dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve, dhe komunitetit;

- Vlerësimi përfundimtar përfshin vlerësimin në fund të çdo periudhe mësimore e përcaktuar me kalendarin shkollor, sipas MASHT-it (përfundim tremujorit të I-rë, II-të, dhe III-të). Vlerësimi përfundimtar nënkupton përmbledhjen e vlerësimeve përmbledhëse brenda një tremujori. Vlerësim përfundimtar quhet dhe vlerësimi i cili realizohet në fund të vitit shkollor, që nënkupton përmbledhjen e tre tremujorëve të paraparë me kalendarin shkollor, i miratuar nga MASHT-i.;
- Vlerësimi për shkallë – realizohet në fund të shkallës kurrikulare;
- Vetëvlerësimin e bën nxënësin më të vetëdijsëm për përparimin e tij dhe gjithashtu e lejon atë të analizojnë dhe krahasojnë idetë e tyre me ato të shokëve, mësuesve, dhe prindërve.

Për vlerësimet me shkrim mësuesi duhet të përdorë situata të jetës reale që përfshijnë shkencën në jetën e përditshme, shoqëri, dhe mjedis. Situatat e zgjedhura duhet të jenë domethënëse dhe tërheqëse. Përveç testeve me shkrim, mësuesit mund të kryejnë vlerësime të bazuara në performancën e nxënësve duke përdorur mënyrat e mëposhtme, si:

- punët praktike
- modelet dhe maketet
- punët laboratorike
- posterat
- projektet kurrikulare dhe ndërlyndore
- detyrat individuale
- debatet
- vrojtimet e mësuesit
- portofolit
- esetë

Mësimdhënësit e shkencave natyrore, për shkak të specifikave që ka fusha, duhet të përdorin sa më shumë instrumente vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, në harmoni me planin zhvillimor të shkollës, me vendimmarrjen e DKA-ve dhe me politikat e MASHT-it.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktiviteti profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit, dhe prindërit)

7. Materialet dhe burimet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera si CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atllase, etj.

Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e nxënësve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabelë shkrimi, tabela interaktive, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike, televizori, videoprojektori, kompjuteri, telefoni, tableti etj.

Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrës, është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma etj.).



**FUSHA
KURRIKULARE**

**SHOQËRIA
DHE MJEDISI**

Programi mësimor: Histori

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzime për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Lënda e Historisë, si pjesë e fushës Shoqëria dhe Mjedisi, në klasën e gjashtë, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësve. Përmes kësaj lënde nxënësit do të kenë mundësi të kuptojnë zhvillimet e shoqërisë njerëzore që nga zanafilla e saj e deri tek fillimi i periudhës së Mesjetës së zhvilluar (shek. X-XI). Duke trajtuar proceset, marrëdhëniet dhe ndërveprimet e grupeve dhe individëve, nxënësit do të mësojnë se si kanë jetuar njerëzit dikur dhe si ka ndryshuar dhe si është transformuar shoqëria njerëzore në vazhdimësi. Kjo lëndë trajton mënyrat e jetesës, botën materiale, mënyrën e organizimit ekonomik, politik dhe kulturor si dhe botën shpirtërore të këtyre qytetërimeve për të kuptuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve dhe vazhdimësinë e tyre në të ardhmen. Nxënësit kuptojnë kalimin nga qytetërimet në lashtësi në qytetërimet mesjetare, duke dalluar lidhjet ndërmjet tyre. Përmes kësaj lënde nxënësit do të mësojnë për ngjarjet, fenomenet, besimet, rolin e personaliteteve, për institucionet dhe vendimmarrjen tek grupet e para shoqërore, në botën antike dhe në mesjetën e hershme.

2. Qëllimi

Qëllimi i lëndës për këtë klasë është, që nxënësit të fitojnë njohuri të përgjithshme për ngjarjet, proceset e personalitete, për periudhën e caktuar historike. Gjithashtu lënda ka për qëllim që të zhvillohet të menduarit historik, kreativ, kritik, për veprimtarinë njerëzore të asaj periudhe, gjë që do të ndikojë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i përgjegjshëm, i cili do të respektojë identitetet dhe përkatësitë e ndryshme, si ato: gjinore, etnike, racore, shoqërore, kulturore, të besimit, orientim seksual etj.

3. Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e gjashtë i arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së tretë (Shk. 3) në Kurrikulën Bërthamë II:

Koncepti		
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	<p>RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to</p> <p>1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapsinor.</p> <p>1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.</p> <p>6. Përdorë në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore</p> <p>6.1. Përzgjedh dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve digjitale që kanë të bëjnë me raportet shoqërore dhe dukuritë natyrore e mjedisore.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Parahistoria - Bashkësitë e para njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan specifikat kryesore të shkencës së historisë. Dallon periudhat kryesore në histori, dhe përkufizon mënyrat e llogaritjes së kohës. • Dallon dukjen e njerëzve neandertalas dhe homosapiensit, tregon rrethanat e krijimit të grupeve/bashkësive të para njerëzore, dhe argumenton nevojën e bashkëjetesës në bashkësi/grup. • Dallon veçoritë kryesore të kohës së gurit dhe të metaleve. • Numëron veprimtaritë e para të njerëzve (ndarja e punës;orientimet profesionale), dhe arsyeton përse praktikoheshin këto profesione. • Shpjegon llojet e burimeve historike si një domosdoshmëri për argumentimin e ngjarjeve historike.
	Personalitetet të shquara në Antikë dhe Mesjetën e Hershme	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon dijetarët kryesorë grek në Antikë, veprimtarinë e tyre edhe vlerëson kontributin e tyre. • Specifikon personalitetet historike të Lindjes së Lashtë, të Romës (romake) dhe Greqisë së Lashtë si dhe krahason kontributin e tyre në kontekstin e dhënë historik. • Identifikon personalitetet e shquara ilire, analizon veprimtarinë e tyre në rrethanat e kohës, dhe vlerëson kontributin e tyre në shoqërinë ilire.

		<ul style="list-style-type: none"> • Numëron personalitetet historike në Perandorisë Romake të Lindjes (Bizantin), dhe identifikon veprimtarinë e tyre në Mesjetën e Hershme.
Proceset shoqërore dhe natyrore	<p>RNF:1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to.</p> <p>1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.</p> <p>2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.</p> <p>2.1. Përdorë burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasqyruar lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.</p> <p>3.2. Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Qytetërimet e Lindjes së Lashtë	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rëndësinë e lumenjve të mëdhenj në krijimin e civilizimeve të para (Egjiptit, Mesopotamisë, Kinës, Indisë, Persisë, etj.); • Dallon karakteristikat kryesore të shteteve të para pranë lumenjve të mëdhenj dhe analizon jetën shoqërore-ekonomike në rendin skllavopronar; • Gjen të përbashkëtat dhe të veçantat e vendeve të Lindjes së Lashtë, identifikon llojet e shkrimeve të popujve në Lindjen e Lashtë, dhe dallon veçoritë kulturore të tyre. • Përcakton kufijtë e përgjithshëm kronologjik të qytetërimeve të Lindjes së Lashtë; • Krahason arritjet kryesore të qytetërimeve dhe të popujve të Lindjes së Lashtë (shkrimin, ndërtimet, artin, të arriturat shkencore, etj.);
	Qytetërimet e Mesdheut në Antikit	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon popujt e lashtë të Evropës Juglindore dhe shtrirjen gjeografike të tyre; • Dallon veçoritë kryesore të kulturës së Mikenës dhe Kretës dhe përshkruan specifikat e organizimit shtetëror të qytet-shteteve greke; • Përshkruan shkaqet e ngulimeve/kolonive të grekëve në Mesdhe dhe Iliri;

		<ul style="list-style-type: none"> • Veçon shkaqet e luftërave greko-persiane dhe Luftës së Peloponezisë; • Përshkruar karakteristikat e jetës së përditshme në Greqinë e Lashtë dhe identifikon dallimet e jetesës në Spartë dhe Athinë; • Dallon veçoritë kryesore të organizimit në Maqedoninë e Lashtë, në kohën e Filipit II dhe Aleksandërit të Madh; • Shpjegon zgjerimin e Maqedonisë në kohën e Filipit II dhe Aleksandërit të Madh dhe ndikimin e pushtimit të tyre, të ndryshimeve territoriale, politike, ekonomike dhe kulturore; • Përshkruan rrethanat e themelimit të Romës dhe zgjerimit të saj, zhvillimin shoqëror, kulturor dhe shtetëror dhe analizon raportet në mes shtresave shoqërore; • Shpjegon fazat dhe karakteristikat e zhvillimit shtetëror të Romës (Mbretëria, Republika, Perandoria) interpretimet e ndryshme në lidhje me origjinën e Romës dhe ndjek ndryshimin e pushtetit nga periudha Mbretërisë, në atë të Republikës dhe Perandorisë; • Përshkruan rrethanat e lindjes, përhapjes, legalizimit dhe zyrtarizimit të krishterimit në Perandorinë Romake ; • Përshkruan veçoritë e kulturës romake dhe gjen të përbashkëtat dhe të veçantat e kulturave mesdhetare në antikë;
	<p>Qytetërimi ilir</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Tregon për origjinën, shtrirjen, fiset dhe vendbanimet ilire dhe gjen në hartë shtrirjen e mbretërive Ilire; • Përshkruan shtrirjen e Mbretërive Ilire dhe veprimtaritë e popullsisë ilire në aspektin shoqëror, ekonomik dhe politik; • Përshkruan pozitën e ilirëve në Perandorinë Romake; • Dallon specifikat e kulturës dhe besimit ilir nga kulturat dhe besimet e popujve tjerë;
	<p>Dyndjet e popujve dhe rrjedhojat për qytetërimin evropian</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon shkaqet dhe pasojat e dyndjeve të fiseve barbare në Evropë dhe përshkruan ndryshimet shoqërore pas dyndjeve të tyre në Evropë; • Përshkruan rrethanat e krijimit dhe fuqizimit të shtetit Frank si dhe rolin e Karlit të Madh në formimin e Perandorisë së Shenjtë Romake;

	<p>Lindja e marrëdhënieve feudale Perandoria Romake e Lindjes-Bizanti, Arabët, Sllavët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kupton karakteristikat e feudalizmit të hershem, dhe dallon veçantit e rendit feudal nga ai skllavopronar; • Përshkruan shoqërinë mesjetare dhe shtresat shoqërore në hierarkinë feudale; • Përshkruan shtrirjen territoriale të Perandorisë Romake të Lindjes - Bizantin, situatën politike dhe ekonomike në kohën e Justinianit; • Përshkruan zhvillimet në shkencë, art dhe kulturë te arabët si dhe rrethanat e lindjes së islamit; • Kupton periudhat e dyndjeve të popujve sllav dhe shtrirjen e tyre në Evropë; • Përshkruan arsyet e nismës së kryqëzatave, (Kryqëzata e Parë) dhe ndikimin e saj;
	<p>Arbërit në Mesjetën e Hershme</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon shtrirjen e ilirëve-arbërve në kuadër të Perandorisë Bizantine (pas ndarjes së Perandorisë Romake), analizon përhapjen e marrëdhënieve feudale tek arbërit dhe vlerëson trashëgimin kulturore ilire-arbërore në këtë periudhë historike; • Përshkruan kohën dhe pasojat e dyndjeve sllave në Arbërinë mesjetare; • Përshkruan ndryshimet politike dhe shoqërore të Perandorisë Romake të Lindjes-Bizantit pas Justinianit, dhe analizon pozitën e arbërve në kuadër të organizimit të ri administrativ (Themat); • Shpjegon themelimin e Principatës/Shtetit të Arbrit dhe rolin e themeluesve të saj.
<p>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</p>	<p>RNF:3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</p> <p>3.1. Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p> <p>3.2 Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p> <p>6. Përdor në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit dhe teknologjitë e tjera bashkëkohore.</p> <p>6.2. Përdor teknologjinë adekuate për moshën për të prezantuar idetë e tija para të tjerëve.</p>	

	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Marrëdhëniet shoqërore në Antikë dhe Mesjetë	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon disa nga përmbajtjet e kodit të Hamurabit; • Përshkruan qeverisjen e Romës në kohën e Republikës, dhe kupton pse Roma u quajt “Shtet i së Drejtës”; • Përkufizon shtresat e ndryshme të shoqërisë romake (patricë, plebenj dhe sklevërit); • Shpjegon pozitën e robërve/sklevërve, në Romën e Lashtë si dhe identifikon shkaqet dhe pasojat e kryengritjeve të tyre; • Përkufizon Kodin e Justinianit dhe kupton ndikimin e tij në shoqërinë bizantine e më gjerë; • Kupton zhvillimin e shoqërisë feudale, kulturës dhe shkencës në Mesjetën e Hershme; • Shpjegon tiparet e jetës së përditshme të organizimit shoqëror dhe ekonomik të Perandorisë Bizantine;
	Besimet dhe religjionet	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan format e besimit tek shoqëritë e para njerëzore (anemizmi, totemizmi, politeizmi etj.); • Përkufizon rrethanat historike të Lindjes dhe përhapjes së feve kryesore (Judaizmit, Budizmit, Krishterimit, Hinduizmit, Islamit,) dhe dallon veçorit kryesore të tyre; • Njih dhe përshkruan rrethanat e lindjes së krishterimit; • Shpjegon faktorët historikë që ndikuan në përhapjen e krishterimit dhe zyrtarizimin e tij; • Përkufizon kohën e përhapjes së krishterimit tek Ilirët dhe qendrat e para kishtare tek ta; • Shpjegon rrethanat historike të Lindjes dhe përhapjes së islamit dhe kupton karakteristikat kryesore të tij (“pesë shtyllat e fesë islame”). • Identifikon veçorit dhe ngjashmëritë e feve kryesore (judaizmi, budizmi, krishterimi, hinduizmi, islami);

<p>Vendimmarrja dhe institucionet</p>	<p>RNF:4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme 4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdorë në jetën e tij të përditshme.</p>	
	<p>Tema</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p>
	<p>Institucioni i vendimmarrjes në shoqërinë Antike dhe në Mesjetën e Hershme</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon veçoritë kryesore të vendimmarrjes në shoqëri gjatë periudhës së antikitetit dhe Mesjetës së Hershme;
	<p>Demokracia në kohën Antike</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon shtresat shoqërore në Athinën e Lashtë, dhe shpjegon fillet e demokracisë athinase; • Përshkruan tiparet e demokracisë athinase.
<p>Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</p>	<p>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm 5.1. Inicion aktivitete konkrete grupe me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.</p>	
	<p>Tema</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p>
	<p>Qyteti – organizimi i hapësirës së banimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikon hapësirat e para të vendbanimeve të njerëzve, analizon kushtet mjedisore dhe organizimin e tyre në favor të shoqërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm; • Identifikon qytetet antike, dhe krahason organizimin dhe zhvillimin e tyre nga antikiteti; • Identifikon veprat e shquara arkitektonike, rrethanat e kohës së ndërtimit, funksionin e tyre dhe i çmon ato si trashëgimi kulturore.

4. Udhëzime metodologjike

Realizimi i programit lëndor kërkon përgatitje paraprake. Planifikimi i kujdesshëm dhe përzgjedhja e metodologjive adekuate është çelësi për një mësimdhënie të suksesshme. Rekomandohet që mësimdhënësit të lexoj me kujdes rezultatet e të nxënësve për shkallë (kompetencat) RNSH, rezultatet e të nxënësve për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedisi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së Historisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore), por edhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore.

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për lëndën e Historisë, nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke u harmonizuar njëra me tjetrën në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Suksesi i nxënësve në lëndën e Historisë është i ndërlidhur dhe varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjitha grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare. Kjo arrihet duke përdorur qasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, forma të shumëllojta të punës duke respektuar personalitetin dhe stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimin të diferencuar. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacioni i ri, ushtrime, punë individuale e grupe, hulumtime, detyra, demonstrime, punë me projekte, e të tjera.

Duke pasur në konsideratë specifikat e lëndës, preferohet që aty ku është e mundur të përdoren: loja në përgjithësi dhe loja me role në veçanti, e cila krijon shprehje të komunikimit efektiv, shkathtësi të menduarit kreativ, aftësi bashkëpunuese dhe socializmi; Intervista dhe rrëfimet (historia orale) për mbledhjen e të dhënave për ngjarjet, vendet, personalitetet dhe mënyrën e jetesës gjë që zhvillon shkathtësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit; bashkëpunimi me institucionet, grupet e interesit dhe me shoqërinë civile, si forma që mund të realizohen edhe jashtë hapësirës shkollore, gjithmonë në bashkëpunim me nxënësit, ku mësimdhënësi duhet të ketë rol këshillues, orientues.

Mësimdhënësi ka rol të rëndësishëm edhe në orientimin e nxënësve për shfrytëzimin racional të TIK-ut dhe medias, gjë që iu ndihmon atyre në kompletimin e thithjes së informacioneve dhe përgatitjes për angazhim të suksesshëm. Gjithashtu, organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve. Ato mundësojnë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e vrojtimit, hulumtimit dhe vëzhgimit, interpretimit dhe diskutimit për dukuri të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit.

Mësimdhënësi duhet të merr parasysh edhe mësimdhënien dhe të nxënësve të integruar. Duke ju përmbajtur parimeve të kurrikulës është e domosdoshme që të synohet qasja integruese, ku temat brenda lëndëve të fushës apo dhe fushave tjera të trajtohen në mënyrë të integruar. Ngjarjet, fenomene që ndodhin në shoqëri dhe mjedis nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjeshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve të lëndëve së historisë me mësimdhënësit e lëndëve brenda fushës por dhe me mësimdhënësit e lëndëve të fushave tjera. Kjo garanton që të nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për trajtimin e çështjeve/ temave ndërkurrikulare. Integrimi i këtyre temave me temat/përmbajtjet e lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe mjedisi, ndërvarësinë e tyre dhe në këtë mënyrë të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Me programin e lëndës së Historisë për këtë moshë të nxënësve mund të integrohen të gjitha çështjet/temat ndërkurrikulare:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për medie, dhe
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Këto tema mund të ndërlidhen dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me program. Për shembull kur trajtohen temat për qytetërimet, institucionin e vendimmarrjes, ose demokracinë, mund të ndërlidhen me edukimin për qytetari demokratike, ku liritë dhe të drejtat e njeriut, pjesëmarrja në vendimmarrje mund të shpjegohen në konteste dhe periudha të ndryshme, si ka ndodhë evoluimi i tyre etj. E njëjta qasje vlen edhe në trajtimin e temave tjera si edukimi për paqe, që mund të ndërlidhet me përmbajtjet kur trajtohen diversiteti në shoqëri, toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa, dinjiteti njerëzor. Po ashtu edhe tema e globalizimit dhe ndërvarësisë mund të ndërlidhet fare mirë trajtimin e çështjeve ekonomike, arsimore në periudhat që trajtohen në këtë klasë. Tema e edukimit për media mund të shërbej në kontekstin e hulumtimit të nxënësve për përmbajtje të ndryshme duke siguruar material, fotografi, harta të ndryshme etj. Ndërsa çështja e arsimit për zhvillim të qëndrueshëm

mund të ndërlidhet me raportet dhe ndërvarësinë njeriut me mjedisin jetësor që në fillimet e shoqërisë njerëzore dhe nëpër etapat tjera historike që trajtohen në këtë klasë.

6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë e mësimdhënies dhe kërkon pajtueshmëri dhe konsistencë në gjithë procesin. Mësimdhënësi duhet të harmonizojë vlerësimin me atë që ka planifikuar, synuar, ta arrijë tek nxënësi. Pra, duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektivi të vlerësimit, njohuritë, shkathtësitë, sjelljet, qëndrimet e nxënësve. Për vlerësimin e nxënësve në këtë moshë mund të përdoren forma dhe instrumente të ndryshme, përveç llojeve të ndryshme të testimit, si ai verbal, joverbal, vlerësimi i nxënësve në punë grupore, i punës me projekte etj., mund dhe duhet të bëhen edhe vëzhgime të përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve, dhe shkallës së rritjes së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit, pikë referimi janë rezultatet e

lëndës, të fushës në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkalle. Mësimdhënësi, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve të tyre.

Qasja e kurrikulës së re me kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtutjeshme me nxënësit është e domosdoshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikës që njihet si buletini i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet lista e kontrollit etj.

Që në këtë moshë është e rëndësishme të kultivohet shprehja e vetëvlerësimit e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të nxënësve, ku ata ruajnë punimet e tyre reprezentative, si: intervistat me familjarët, punë individuale ose në grupe për mbrojtjen e mjedisit dhe angazhime të tjera që lidhen me rezultatet e parapara për këtë moshë të nxënësve.

Vlerësimi gjithmonë duhet të ketë karakter motivues, në mënyrë që nxënësi të edukohet, të pranojë vlerësimin real dhe të synojë arritje sa më të larta.

7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Krahas teksteve mësimore bazë, sugjerohet që gjatë procesit mësimor, nxënësit dhe mësimdhënësit të shfrytëzojnë edhe burime të tjera të njohurive siç janë: fletoret e punës, materiale tjera alternative, broshurat, atlaset, hartat, enciklopeditë, softuerët arsimorë, ueb faqet me përmbajtje historike, vizitat e ndryshme njohëse, si, p.sh., monumentet e trashëgimisë kulturore-historike dhe natyrore.

Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë dhe të krijojnë dosje, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm për aktivitete me nxënës. Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e produkteve të ndryshme përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Programi mësimor: Edukatë qytetare**Përmbajtja**

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Lënda Edukatë qytetare në klasën e gjashtë e mëson nxënësin për të menduar në mënyrë kritike e kreative dhe për t'u shprehur në mënyrë të efektshme. Kjo lëndë bën që nxënësi të jetë i suksesshëm, individ i shëndoshë, kontribuues produktiv, e mbi të gjitha qytetar i përgjegjshëm. Në lëndën Edukatë qytetare, trajtohen çështjet si: marrëdhëniet shoqërore, ndërlidhjet dhe ndërveprimet e individit me grupin dhe me institucionet, të drejtat dhe përgjegjësitë, vendimmarrja, mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Për të qenë qytetar i denjë i vendit, nevojiten, jo vetëm njohuri mbi botën dhe shoqërinë, por edhe mbi vetveten. Për këtë qëllim, programi i kësaj lënde shtjellon tema që kanë të bëjnë me veprimet konkrete dhe praktike, qofshin ato individuale, grupore apo institucionale.

Përmbajtja e lëndës Edukatë qytetare përfshinë një spektër të gjerë temash për qytetarinë, në mënyrë që nxënësi të kuptojë rëndësinë e përkatësisë në grup, strukturën dhe funksionimin e grupit, si dhe ndërlidhjen dhe ndërvarjen e grupit me grupet tjera. Kjo lëndë mëson si të tejkalohen sfidat që paraqiten në lidhje me përfshirjen dhe bashkëveprimin në grup, duke pas parasysh aspektet psikologjike, sociale dhe kulturore të saj, si: emocionet, shkathtësitë, vullnetin, kohezionin, integrimin, socializimin, solidaritetin, paragjykimin, diskriminimin, identitetin, diversitetin etj.

Nxënësi i kësaj moshe duhet të kuptojë raportin me rrethin shoqëror dhe të reflektojë mbi mjedisin ku jeton. Prandaj Edukata qytetare ndihmon nxënësin për të zhvilluar potencialin e vet intelektual, moral dhe social dhe për të menduar e vepruar si një qytetar i përgjegjshëm. Kjo ndihmon kujdesin për vetën dhe për të tjerët, për mjedisin dhe biodiversitetin, për respektimin e ligjit dhe institucionit, për kultivimin e vlerave qytetare dhe të demokracisë, për ruajtjen e identitetit dhe përkatësisë. Edukata qytetare në klasën e gjashtë kultivon te nxënësi dashurinë ndaj njerëzve, ndaj vendit, kulturës, jetës dhe botës në përgjithësi.

2. Qëllimi

Për nxënësit e klasës së gjashtë është shumë me interes të mësohet lënda Edukatë qytetare, sepse moshën 11-12 vjeçare paraqet fazë shumë delikate për zhvillimin e personalitetit, si në kuptimin e pajisjes me dije dhe shkathtësi për jetë, ashtu edhe të rrezikut për sjellje devijante ose delikuate. Kjo është koha kur fillon puberteti dhe rreziku për sjellje, ndikime dhe orientime të gabuara të fëmijëve. Prandaj, Edukata qytetare, e udhëzon fëmijën për sjellje dhe veprime të drejta e të dobishme si për vetveten, ashtu edhe për familjen, rrethin dhe shoqërinë.

Interesi i familjes, shkollës dhe shoqërisë është që fëmija t'i arrijë kompetencat jetësore të parashtruara në Kurrikulën Bërthamë 2, pra fëmija të jetë: komunikues efektiv, mendimtar kreativ, nxënës i suksesshëm, individ i shëndoshë dhe qytetar i përgjegjshëm. Qëllimi i lëndës Edukatë qytetare është që t'i ndihmojë nxënësit për të fituar këto kompetenca dhe për tu bërë qytetar i denjë i vendit të vet.

3. Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e gjashtë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL), për temat e

përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF), Shoqëria dhe mjedisi, të shkallës së tretë të kurrikulës (Shk. 3), në Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	RNF: 1. Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Grupi dhe karakteristikat e tij	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Identifikon llojet e ndryshme të grupeve shoqërore bazuar në formën, përmbajtjen, strukturën, funksionin, dinamikën dhe marrëdhëniet shoqërore, duke marrë shembujt si: familja, shkolla, klubi, shoqata, organizata etj; ▪ Përshkruan llojet e lidhjeve sociale të individit me grupin dhe të grupit me grupin tjetër, si dhe ndikimin e atyre lidhjeve në krijimin e identitetit personal dhe grupor; ▪ Dallon rolin e individit në kuadër të grupeve shoqërore, duke pas parasysh kontekstin kohor dhe hapësinor; ▪ Përshkruan profilin personal dhe social të liderit, sjelljen, aftësinë, përkushtimin, vizionin dhe rolin e tij për zhvillimin e grupit; pastaj, kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e liderit, për zëvendësimin e tij;
	Identiteti personal dhe grupor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallon tiparet e identitetit personal dhe atij grupor si dhe lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet këtyre dy formave të identitetit; ▪ Përcakton veçoritë dalluese të individit me theks të veçantë mendimet, qëndrimet, vlerat, sjelljet, veprimet dhe mënyrën e komunikimit; ▪ Vlerëson rëndësinë e komunikimit të hapur dhe transparent, bashkëpunimit, mirëkuptimit, tolerancës dhe frymës konstruktive për konsolidimin dhe promovimin e grupit dhe pjesëtarëve të tij; ▪ Shfaqë mendimin, qëndrimin, dëshirat, interesat dhe mbrojnë të drejtat personale, pa atakuar dëshirat interesat dhe të drejtat e tjetrit; ▪ Vlerëson rëndësinë e dialogut, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në zgjedhjen paqësore të konflikteve.

Proceset shoqërore dhe natyrore	RNF: 2.	
	2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human të vendeve, regjioneve në nivel lokal, regional.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Mënyrat e jetesës dikur dhe sot	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahason mënyrën e jetesës dikur dhe sot, duke u bazuar në të dhëna arkeologjike, historike, etnologjike (kulturore), të shkruara dhe elektronike; ▪ Dallon faktorët kryesor që kanë ndikuar në ndryshimin e mënyrës së jetesës së njerëzve dhe vlerëson kontekstin gjeografik, kulturor, historik, politik të këtyre ndryshimeve;
Natyra, kultura dhe shoqëria	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkruan lidhjen ndërmjet natyrës dhe aspekteve të saj fizike, gjeografike, klimaterike, ekologjike, me kulturën dhe shoqërinë njerëzore; ▪ Krahason dijet dhe besimet e hershme mbi natyrën me dijet moderne si rezultat i zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë. ▪ Shpjegon raportin e njeriut me natyrën duke theksuar varshmërinë dhe ndikimin reciprok, pastaj mënyrat e eksplorimit teknologjik, shfrytëzimit ekonomik, si dhe reprezentimit artistik të natyrës; 	

Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë	RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitetet	
	3.1.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Normat morale dhe ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krahason normat ligjore me normat morale, fetare dhe zakonore; ▪ Vlerëson e rëndësinë e ligjit për rregullimin e jetës shoqërore; ▪ Analizon praktikat dhe procedurat ligjore: si dhe pse nxirren ligjet, si dhe pse respektohen, si dhe pse ndryshohen;
Vlerat kulturore dhe qytetare	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallon llojllojshmërinë e vlerave kulturore dhe shpjegon rëndësinë e diversitetit kulturor për shoqërinë dhe botën bashkëkohore; ▪ Vlerëson trashëgiminë kulturore dhe natyrore të vendit dhe kujdeset për mbrojtjen e saj; ▪ Vlerëson rëndësinë e paqes, tolerancës, transparencës, llogaridhënies, gjithpërfshirjes, lirisë, barazisë dhe demokracisë; 	
Të drejtat dhe përgjegjësitë	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerëson dhe respekton të drejtat e njeriut, të drejtat e grave dhe të drejtat e fëmijëve; ▪ Identifikon llojet e të drejtave të njeriut dhe dokumentet ndërkombëtare për to; ▪ Analizon përgjegjësitë qytetare, respektimin e ligjit dhe institucionit, respektimin e të drejtave dhe lirive elementare njerëzore, angazhimin për mirëqenie, prosperitet dhe jetë demokratike. 	

Vendimmarrja dhe institucionet	RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme	
	4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdorë në jetën e tij të përditshme.	
	4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Vendimmarrja individuale/personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Jep dhe shqyrton ide, propozime dhe opsione të ndryshme për të marrë vendime të duhura dhe të përgjegjshme në jetë; ▪ Analizon përparësitë, por edhe parashikon pasojat e mundshme të një vendimi personal, në një situatë konkrete; 	
Vendimmarrja grupe/institucionale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vlerëson nevojën e konsultimit, bashkëpunimit dhe harmonizimit të interesave të palëve të ndryshme për vendimmarrje demokratike. 	
Mjedi-si dhe zhvillimi i qëndrueshëm	RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm	
	5.1. Inicion aktivitete konkrete grupe me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.	
	5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
Kultura mjedisore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Veçon elementet përbërëse të mjedisit dhe vlerëson rolin e mjedisit të pastër për jetë të shëndetshme; ▪ Përshkruan shkaqet dhe format kryesore ndotjes së mjedisit dhe shpjegon pasojat e shumëfishta të ndotjes, si për njerëzit ashtu edhe për gjallesat tjera; ▪ Numëron veprimet dhe përgjegjësitë individuale, grupe dhe institucionale për ruajtjen e mjedisit; ▪ Identifikon masat mbrojtëse që duhet t'i marrë shteti për ta mbrojtur mjedisin, natyrën, ekosistemin dhe biodiversitetin; ▪ Demonstron shkathtësi personale si: kursimi i ujit, energjisë, ruajtja e gjelbërimit, dashuria për natyrën dhe biodiversitetin. 	

4. Udhëzime metodologjike

Për arritjen e rezultateve të parapara në programin e lëndës Edukatë Qytetare në klasën e gjashtë përdoren një mozaik metodash dhe teknikash të mësimdhënies. Duke synuar vlerat humane dhe qytetare, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore, kujdesin për mjedisin, njohuritë për grupet dhe marrëdhëniet shoqërore, respektimin e diverzitetit kulturor dhe atij natyror, respektimin e ligjit dhe institucionit, duhet të përdorim një metodologji komplekse dhe gjithësi adekuate. Kjo bëhet me qëllim të zhvillimit të individit në kontekstin e zhvillimit

të shkathtësive për jetë, sidomos aftësive dhe nevojave për qytetari aktive.

Strategjitë, metodat dhe teknikat që shërbejnë për arritjen e rezultateve tek nxënësit bëhen në bazë të organizimit të mirë të punës në shkollat tona, e ndonjëherë dhe jashtë saj. Ato janë: puna individuale, në dyshe, në grupe, me shkrim, me gojë, ese, debate vizita mësimore, me dosje (portfolio), projekte, me role, expozita, punë vullnetare, studime rasti, vëzhgim në terren, biseda me të afërm, filmim, lexim, shikim të fotografive, të filmave dhe dokumentarëve, përcjellje të medieeve dhe internetit.

I gjithë organizimi bëhet duke pasur parasysh nxënësin në qendër, gjithëpërfshirjen, nxënien e diferencuar, qasjen e integruar, çështjet ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare dhe arritjes së të nxënit në bazë të kompetencave të parapara për shkallën e tretë kurrikulare në Kurrikulën Bërthamë 2. Këtu duhet të kontribuojnë të gjithë: familja, shkolla, komuniteti apo bashkësia, mediet, shteti dhe gjithë shoqëria.

5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare, janë çështje që domosdo, janë të ndërlidhura me rezultatet e fushës, andaj duhet t'i kushtohet vëmendje trajtimit adekuat edhe në programet lëndore. Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e fushës, temat dhe njësitë mësimore, dhe të parashoh se me cilat çështje ndërkurrikulare ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi sa më i mirë i këtyre çështjeve duke marrë parasysh edhe mësimdhënien e integruar. Çështjet ndërkurrikulare që mund të përfshihen në lëndën

Edukatë qytetare janë:

- Edukimi për media
- Edukimi për paqë
- Edukimi për qytetari demokratike
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Të drejtat dhe liritë e njeriut
- Zhvillimi i qëndrueshëm

Këto tema e ndihmojnë mesimëdhënies që të përqendrohet në atë, që nxënësi duhet të bëjë, krahas asaj që ai (nxënësi), është në gjendje të kuptojë, apo të mësoj. Në themel të kësaj qasjeje që vë në qendër nxënësin dhe atë që ai duhet të bëjë janë tri parimet bazë, që mund të ilustrohen me shembullin e mëposhtëm:

- Nxënësit njohin, kuptojnë dhe vlerësojnë të drejtën e mendimit dhe të shprehjes së lirë dhe mënyrën si ajo mbrohet nga kushtetuta apo ligjet e shtetit. Ky përbën dimensionin njohës të të mësuarit (njohuritë, konceptet dhe të kuptuarit).
- Nxënësit nxiten të reflektojnë për pikëpamjet e tyre dhe të jenë të aftë t'i shprehin ato në mënyra të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe aftësinë për t'i argumentuar ato publikisht (përmasa e të mësuarit që lidhet me aftësitë).

- Nxënësit dëgjojnë mendimet e të tjerëve në frymën e tolerancës dhe të respektit, duke mos i personalizuar ndryshimet e tyre, krijohet mundësia që mosmarrëveshjet të zgjidhen në mënyrë paqësore (përmasa e të kuptuarit që lidhet me qëndrimet dhe vlerat).

Më shumë për këto çështje konsultojeni Kurrikulën Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Ulët!

6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi bëhet me qëllim përparimi të nxënësit dhe ndjekjes së progresit në nxënie. Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë, mjetet didaktike të nevojshme dhe kërkon konsistencë në gjithë procesin. Ajo realizohet në forma të ndryshme njësoj si mësimdhënia, p.sh., testet e llojeve të ndryshme si: teste verbale e joverbale, objektive e subjektive, vlerësim formativ e sumativ, me prezantime të projekteve të ndryshme etj. Mbi të gjitha qëllimi është të vëzhgohet përvetësimi i njohurive, sjelljeve, qëndrimeve dhe shkallës së arritjes së shkathtësive dhe aftësive të nxënësit, e në fund të fundit të vetëvlerësimit që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojë arritje sa më të larta.

7. Materialet dhe burimet mësimore

Edukata qytetare mund të realizohet jo vetëm përmes teksteve të ndryshme mësimore, por edhe me shumë burime të tjera si: libra të ndryshëm për ushtrime, fletore pune, broshura gazeta, përdorim të internetit, hartat, enciklopedi, gazeta ditore dhe periodike, radio dhe televizioni, projekte të ndryshme empirike, programe softuerike, intervistat, vizitat mësimore, revistat, sjellja e ekspertit në ambiente klase etj.

Natyrisht, të gjitha këto burime duhet t'i sigurojë mësimdhënësi në bashkëpunim me stafin e shkollës, stafin prindëror etj., në përjashtim të rastit, kur arsimtari angazhon nxënësit të hulumtojnë në mënyrë të pavarur individuale ose si grup, për tema të caktuara në kuadër të lëndës.

Programi mësimor: Gjeografi

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzime për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasën e gjashtë është ndërtuar, bazuar në nivelin e I-rë të Arsimit Parauniversitar, ku aspektet gjeografike janë të integruara në kuadër të fushës: Shoqëria, Mjedisi dhe Shkencat e Natyrës.

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasën gjashtë rrjedh nga: KKK¹ dhe KB² e Arsimit Parauniversitar, rezultatet e të nxëniet të kompetencave, RNF³-Shoqëria dhe Mjedisi, dhe Planit mësimor të Arsimit të Mesëm të Ulët.

Lënda e Gjeografisë në këtë klasë fokusohet në njohjen me pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, madhësinë dhe strukturën e saj, paraqitjen e saj në rrafsh dhe modele tjera të njohura, përdorimin e hartës dhe mekanizmave tjerë të nevojshëm për interpretim gjeografik. Fokusi i radhës është mjedisi gjeografik me të gjithë parametrat fizik- gjeografik, të nevojshëm për nivelin e njohurive të nxënësve në këtë shkallë të Arsimit Parauniversitar. Fokusi përfundimtar, dhe po aq i rëndësishëm është komponentë humane e mjedisit gjeografik me të gjitha veprimtarit dhe faktorët natyror e human me ndikim në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Programi i Gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxëniet gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxëniet.

Me këtë plan program nxënësi përvetëson njohuri të reja dhe terminologjinë gjeografike, njëkohësisht zbulon rolin që duhet të përmbushë si individ për zhvillimin e qëndrueshëm. Ai mëson t'u përgjigjet problemeve njerëzore duke aplikuar suksesshëm njohuritë gjeografike.

Njohuritë e rregullta nga mësimet teorike, vëzhgimet dhe puna në terren, puna me hartën zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi duke mundësuar interpretim analitik të shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe humane në Tokë dhe ndërvarësitë midis tyre.

Lënda e Gjeografisë për klasën e gjashtë, trajton përmbajtjet lëndore, në përputhje me moshën e nxënësve. Zhvillimi i planit dhe programit mësimor të Gjeografisë për këtë klasë është ndërtuar mbi bazën e procedurës shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës si dhe parashtrimi i rezultateve të të nxëniet për kompetenca, rezultateve të të nxëniet të Fushës, si dhe të instrumenteve të vlerësimit. Ai synon që nxënësit të nxiten të eksplorojnë dhe të zhvillojnë dije, shkathtësi, shprehi, qëndrime dhe vlera.

2. Qëllimi

Qëllimi i lëndës së Gjeografisë në kuadër të fushës: Shoqëria dhe Mjedisi, është zhvillimi i njohurive dhe shkathtësive gjeografike lidhur me Tokën dhe Sistemin Diellor, sistemet fizike (natyrore), sistemet humane (shoqërore), dhe rajonet gjeografike.

Njohuritë e fituara nga lënda e Gjeografisë ndikojnë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të nxënësit si një personalitet i qëndrueshëm dhe qytetar i

¹ KKK-Korniza e Kurrikulës së Kosovës

² KB-Kurrikula Bërthamë

³ RNF- Rezultatet e të Nxëniet të Fushës

përgjegjshëm.

3. Temat dhe rezultatet e të nxënit

RNL-të në këtë program mësimor, janë bazuar në temat e lëndës, në përputhje me RNF-të, dhe konceptet e fushës, në harmoni me RNSH. Këto rezultate i mundësojnë mësimdhënësit që të hartojë njësi mësimore për të arritur rezultatet e definuar në këtë dokument.

RNL-të i mundësojnë mësimdhënësit nxjerrjen e njërive mësimore duke respektuar autonominë e tij dhe të shkollës. Kjo u jep liri mësimdhënësve, që në përputhje me kushtet konkrete, jo të barabarta (nxënësit, pajisjet, etj.), të mund të zgjedhin metodologji përkatëse , por duke u bazuar në RNL dhe RNF.

Programi lëndor i Gjeografisë për klasën e gjashtë është i ndërtuar në këto tema:

Tema 1: Vendi dhe hapësira

1. Tema 2: Sistemet fizike-Gjeosferat
2. Tema 3: Sistemet humane

Tema 4: Bashkëveprimi njeri/natyrë

Koncepti		
<p>1. Proceset shoqërore dhe natyrore</p> <p>2. Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</p>	<p>RNF: 2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, paraqitjen e Tokës në hartë dhe glob, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen, ndërtimin dhe strukturën e gjeosferave, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to dhe bashkëveprimin njeri/natyrë në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtarë</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	<p>1. Vendi dhe hapësira</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/ vendi, mjedisi, regjion, ndërveprimi dhe zhvillimi; • Përshkruan formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre; • Identifikon veçoritë kryesore të Tokës e Sistemit diellor, të planetëve, asteroideve, kometave, satelitëve dhe Hënës si trup qiellor dhe satelit natyror i Tokës; • Vlerëson rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike; • Identifikon provat dhe pasojat e lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vet;

		<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth rreth Diellit; • Përcakton kohën vendore dhe zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike; • Përshkruan mënyrat e orientimit në natyrë (me anë të Diellit, orës, myshqeve, Yllit Polar, busullës, objekteve fetare, etj.); • Krahason hartën dhe globin, duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre (elementet matematike dhe gjeografike të hartës të hartës); • Mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme; • Shpjegon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (rrjetin e paraleleve dhe meridianëve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike); • Përshkruan përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë dhe lartasin absolute dhe relative; • Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.
	<p>RNF: 2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, paraqitje e Tokës në hartë dhe glob, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen, ndërtimin dhe strukturën e gjeosferave, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to dhe bashkëveprimin njeri/natyrë në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtarë</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	3. 2.Sistemet fizike -Gjeosferat	<ul style="list-style-type: none"> • Diferencon shtresat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre; • Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive e brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene), krijimin e tyre; • Përshkruan format relievoe, llojet dhe shkaktaret e krijimit (format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme); • Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre • Përshkruan shkaqet e tjetërsimit (alterimit), kushtet në cilat zhvillohet procesi i karstit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike;

		<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, eolik dhe abraziv; • Argumenton pasojat globale të shkrirjes së akullnajave. • Shpjegon rolin e relievit në veprimtaritë njerëzore dhe rreziqet në litosferë; • Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat ryesore të tyre; • Përshkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndryshimet në planin horizontal dhe vertikal; • Gjen temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit dhe amplitudat ditore dhe vjetore të temperaturës së ajrit; • Shpjegon shtypjen atmosferike, ndryshimin e saj, rolin e saj në erëra dhe në vetë jetën e njeriut; • Përshkruan konceptet lagështi e ajrit dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike; • Punon dhe interpreton grafikët e shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve; • Formulon konceptet mot dhe klimë, dhe të bënë dallimin midis tyre; • Identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës dhe zonat klimatike nga ekuatori në pole; • Përshkruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën dhe qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetit fizike e kimike të ujit të Detit botëror; • Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të Detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën); • Identifikon format kryesore të zhvillimit horizontal të bregdetit, duke veçuar veçoritë kryesore të tyre; • Identifikon llojet e ujërave nëntokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit; • Diferencon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre;
--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën); • Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.
	<p>RNF: 1.3. Shpjegon organizimin e hapësirës së banimit e të veprimtimit, shpërndarjen, lëvizjen natyrore, strukturat, migrimet e popullsisë, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike në nivel lokal, vendi, rajonal dhe botëror.</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)
	3. Sistemet humane	<p>Përshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizja numerike, dendësia, lëvizjen natyrore dhe teorinë e tranzicionit demografik);</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë; • Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve; • Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksionet dhe kriterit kryesore të tyre; • Identifikon elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare; • Përshkruan veçoritë themelore ekonomike-geografike në botë si faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik; • Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor); • Shpjegon llojet dhe rëndësinë e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë, etj.) ; • Identifikon degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj; • Përshkruan procesin e industrializimit. • Identifikon degët kryesore të industrisë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj;

		<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon veçorit e transportit t (auto-mobilistik, hekurudhor, ujqor, ajror) dhe rolin e tij në zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe vet ekonomisë; • Përshkruan rëndësinë e tregtisë për zhvillimin ekonomik. • Shpjegon rolin e turizmit dhe veprimtarive tjera (të sipër përmendura) në zhvillimin ekonomik; • Vlerëson rolin e turizmit në shoqërinë bashkëkohore.
	<p>RNF: 2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, paraqitje e Tokës në hartë dhe glob, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen, ndërtimin dhe strukturën e gjeosferave, dukuritë dhe proceset që ndodhin në to dhe bashkëveprimin njeri/natyre në nivel lokal, regjional dhe ndërkombëtar</p>	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	4.Bashkëveprimi njeri/natyre	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas; • Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore; • Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore; • Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre.

4. Udhëzime metodologjike

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e Gjeografisë, janë një ndër pikat kyçe të programit për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesimin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

1. Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit është kompetencë profesionale e mësimdhënësve.

Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, teorik edhe aplikativ të tregohet kujdes i veçantë. Metodologjia duhet të përzgjidhet paraprakisht në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, në përshtatje me përmbajtjen e temës që do të zhvillohet, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia duhet të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, që kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme. Metodat didaktike duhet të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimin, në përputhje me karakterin e dijeve, të rezultateve lëndore si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

- Mësimdhënia dhe të nxënit, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësimdhënësit e kësaj lënde duhet:
 - Të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit;
 - Të nxitin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë sa herë që është e mundur);
 - Të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
 - Të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar partner të vetin dhe duke kuptuar se në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
 - Të mbështesin të nxënit e pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët, përmes punës me projekte, punës në grupe, punës individuale, etj.
 - Të kenë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës "Shoqëria dhe Mjedisi", zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore.
 - Të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por jo të vetmin për përmbushjen e kompetencave;
- Të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënit.

- Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:
- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit.
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin;

Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në ambiente ekonomike (industriale, xehtare, fusha bujqësore, zona turistike, hapësira trafiku, etj. (sa herë që është e mundur).

Për realizimin e programit, mësimdhënësi duhet ketë parasysh edhe parimet bazë në mësimin e Gjeografisë. Ai gjatë realizimit të programit të Gjeografisë i udhëheq nxënësit në mënyrë që ata me aktivitetet e tyre në klasë, kabinet, etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojë, mbledh të dhënat, të mbikëqyr, të mendojë në mënyrë të pavarur, të mbrojë dhe argumentojë mendimet e tij, duke u nisur prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.

Në shkencën e Gjeografisë si për njohuritë teorike, ashtu edhe për njohuritë empirike që përmban kjo lëndë, krijohen një sërë sistemesh njohurish, sikundër janë njohuritë gjeomorfo-gjeografike, klimo-gjeografike, hidro-gjeografike bio-gjeografike, ekonomiko-gjeografike, turistiko-gjeografike, demogjeografike, etj.

5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën Shoqëria dhe Mjedisi i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

- Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në fushën Shoqëria dhe Mjedisi për këtë moshë të nxënësve janë:
- Edukimi për medie
- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë

Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm

Edukimi për medie

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të medieve për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë

Aftësitë për jetën ndihmojnë nxënësit të marrin vendime të argumentuar mirë, të zgjidhin probleme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyra të shumëllojshme dhe të efektshme, intelektuale dhe emocionale para të tjerëve, si dhe të ndërtojnë jetën e tyre në mënyrë të shëndetshme të sigurt. Gjatë zhvillimit të kësaj çështje rrisin sigurinë e shëndetit të tij dhe të tjerëve, në mënyrë që të jenë të aftë të ndërtojnë hapa të sigurt në mjedisin e tyre dhe më gjerë.

Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësi të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijesimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimi ekonomik dhe mjedisor. Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërlidhet me vetëdijesimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

6. Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënësve në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësimdhënësi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësit, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësi të kompetencave të fushës Shoqëria dhe Mjedisi. Vlerësimi u shërben mësimdhënësve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënësve si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësimdhënësi duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

- Vlerësimi duhet të jetë i besueshëm dhe i paanshëm;
 - Nxënësit duhet t'u jepet mundësia të demonstrojnë shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve;
 - Vlerësimi duhet t'u ndihmojë nxënësit, t'u japë informacion pozitiv dhe nxitës për t'u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënësve;
- Vlerësimi udhëhiqet nga rezultatet e të nxënësve dhe shfrytëzon shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënësve;

- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimi të vështirësive gjatë procesit të nxënimit;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të nxënimit;
- Vetëvlerësimi të nxënësve;
- Përmirësimi të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi kërkon:

- Rezultate të qarta mësimore
- Motivim të nxënësve
- Njohjen e përvojës dhe e aftësive të nxënësve

Kërkesa të qarta të nxënësve dhe metoda e teknika mësimore efikase

Vlerësimi bazohet në:

Ç' thonë, Ç' shkruajnë dhe Ç' bëjnë nxënësit?

Etapat e vlerësimit:

- Kontrolli, p.sh. çka din (çka është arritur) dhe çfarë nuk din nxënësit (çka nuk është arritur).
- Matja, ajo që kontrollohet matet.

Vlerësimi, nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi, sasior ose cilësor bazuar në matje me notë.

Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:

- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.)
- Vlerësimi me shkrimë
- Vlerësimi me anë të dëgjimit
- Vlerësimi përmes punës praktike
- Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve
- Vlerësimi i projekteve kurrikulare, lëndore ose ndërlëndore
- Esetë
- Portofoli

Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar

7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënimit në lëndën e Gjeografisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme,

si: harta të përgjithshme, tematike, atlase, albume, foto, skica, modele, makete, diagrame, mjete grafike, filma mësimorë, kompjuter, projektor, CD, DVD etj. Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesional, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.

Mësimdhënësi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë qasje në burimet e ndryshme të të nxënës. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në Gjeografi, është e larmishme: muzeume, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive, pjesëmarrje në ngjarje kulturore, sportive, etj. Gjithashtu, burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

- **Sugjerime për përdorimin e TIK-ut**
- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim të informacionit.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar ueb-et për gjeografinë.
- Përdorimi i PC për mbledhjen e informacionit për temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm softuerëve
- Përdorimi i grafikëve softuerëve.

Paraqitja grafike e të dhënave.



FUSHA KURRIKULARE

EDUKATË
FIZIKE,
SPORTE DHE
SHËNDETI

Programi mësimor: Edukatë Fizike, Sporte dhe Shëndeti

Përmbajtja

1. Hyrja
2. Qëllimi i lëndës
3. Njësitë tematike/mësimore përgjatë një klase/viti shkollor
4. Rezultatet e të nxënit të lëndës për tema
5. Udhëzime metodologjike
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet didaktike dhe burimet e mjetet mësimore

1. Hyrja

Edukatë Fizike, Sporti dhe Shëndeti është pjesë e pandarë e formimit fizik dhe mendor, e pasurisë shpirtërore dhe kulturës njerëzore në të gjitha etapat e jetës.

Lënda: Edukatë fizike, sporti dhe shëndete, synon të përforcojë njohuritë e çdo nxënësi/e dhe do t'i sigurojë atij/asaj përvoja, aftësi dhe njohuri të reja, të cilat do të zgjerojnë edhe më tej formimin kulturor, fizik e shëndetësor. Njohja, realizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë fizike, sportive nga të gjithë nxënësit është një formë e të vepruarit në grup, dhe ndikon në përforcimin e marrëdhënieve shoqërore dhe komunikuese.

Edukata Fizike, Sporti dhe Shëndeti kërkon që përmes studimit edhe të lëndëve të tjera në fushat sociale, shkencore, si dhe të arteve (pjesë përbërëse këto në Kurrikulën Bërthamë), të arrihet krijimi dhe plotësimi i përgjithshëm i kulturës dhe formimit të nxënësve, i cili arrihet përmes disa linjave kryesore të procesit mësimor të edukimit fizik dhe shëndetësor.

Procesi i edukimit fizik dhe shëndetësor luan rol themelor në përgatitjen e nxënësve për realizimin e veprimtarive kulturore-sportive, artistike dhe shkollore.

Ky proces merr rëndësi të veçantë veçanërisht në realizimin e garave e ndeshjeve ose veprimtarive të tjera të kombinuara me ato artistike, shoqërore e shëndetësore. Organizimi dhe realizimi i kësaj lënde do t'i ndihmojë nxënësit të vlerësojnë efektet e pozitive të saj në shumë drejtime, jo vetëm në aspektin shëndetësor dhe fizik por edhe në atë të marrëdhënieve midis njëri - tjetrit, në atë të zgjerimit të njohurive për kulturat e rajoneve e të vendeve të ndryshme, në atë të krijimit të një mjedisi më shoqëror, pasi në këto veprimtari nuk duhet të ketë humbës, por të gjithë fitojnë. Kjo përbën në esencën e vet synimin dhe vlerën më të madhe të procesit edukativ në lëndën Edukatë Fizike, Sporte dhe Shëndeti.

2. Qëllimi i lëndës

Të realizojë të gjitha rezultatet e lëndës Edukatës Fizike, Sportet dhe Shëndeti, të përcaktuara në programin mësimor dhe që shprehen në mënyrën më të plotë nëpërmjet procesit mësimor praktik e teorik. Të zhvillojë dhe të stimulojë një shëndet sa më të plotë në aspektet fizik, psikologjik, shpirtërorë dhe shoqërorë; të formojë tek nxënësi/ja aftësi dhe shprehje lëvizore të vlefshme për të gjithë jetën, si dhe të formojë tek ai/ajo një model të jetës se shëndetshme, aktive; të formojë dhe të përforcojë koncepte, si: përgjegjshmëria, individi, grupi, shoqëria, rregulli, diversiteti, aktiviteti dhe kontributi shoqëror etj

- **Njësitë tematike**
- Aktiviteti fizik dhe shëndeti
- Sportet individuale
- Antropometria dhe motorikja
- Rregullat elementare dhe elementet teknike të sporteve kolektive
- Ushqimi dhe shprehitë e të ushqyerit
- Çrregullimet e të ushqyerit dhe puberteti
- Substancat dhe medikamentet
- Mjedisi natyror dhe artificial

3. Rezultatet e të nxënit të lëndës për tema

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
Mirëqenie plote fizike, psikike, emocionale dhe sociale	Aktiviteti fizik dhe shëndeti	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan rendësin e shëndetit fizik dhe emocional, kupton rëndësinë dhe elementet e shëndetit emocional; Përshkruan situatat e ndryshme të rrezikshme dhe tregon vetëbesim në menaxhimin e tyre;
Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive	Sportet individuale	<ul style="list-style-type: none"> Demonstron elementet teknike nga disiplinat e atletikës; Demonstron dhe kompozon ushtrime themelore në parter nga gjimnastika sportive dhe ritmike; Vlerëson lidhshmërinë në mes të ushtrimit të realizuar korrekt dhe vlerën estetike të ushtrimeve; Demonstron elementet themelore të teknikave në sportet luftarake mundje karate etj.; Demonstron elementet teknike në pingpong, tenis, badminton etj.; Përshkruan dhe demonstroi elementet teknike në ujë; Përshkruan dhe demonstroi elementet teknike në borë;
	Antropometria dhe motorikja	<ul style="list-style-type: none"> Liston matjet antropometrike sipas teknikave; Demonstron aftësitë motorike dhe kupton mënyrën e matjes së tyre; Përshkruan dhe përcjell rezultatet e arritura të aftësive motorike;
	Rregullat elementare dhe elementet teknike të sporteve kolektive	<ul style="list-style-type: none"> Përshkruan rregullat elementare dhe demonstroi elementet teknike në Basketboll; Përshkruan rregullat elementare dhe demonstroi elementet teknike në Futboll; Përshkruan rregullat elementare dhe demonstroi elementet teknike në Volejbol; Përshkruan rregullat elementare dhe demonstroi elementet teknike në Hendboll; Përdore rregullat themelore të basketbollit atletikës dhe gjimnastikës në lojëra dhe gara;

<p>Promovimi i stilit aktiv dhe te shëndetshëm te jetës</p>	<p>Ushqimi dhe shprehjet e të ushqyerit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Liston ushqimet në baze të prejardhjes dhe përshkruan etiketat ne ushqimet e paketuara; • Përshkruan ushqimet të cilat konsumohen varësisht nga koha dhe mosha; • Përshkruan mënyrat e mirëmbajtjes dhe përdorimit të ushqimeve; • Dallon rëndësinë e ushqimit dhe ndikimin pubertet -gjate rritjes; • Njeh ndryshimet fiziologjike që ndodhin gjate rritjes;
	<p>Çrregullimet e të ushqyerit dhe puberteti</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan faktorët që ndikojnë në mbipeshe dhe obeziteti; • Përshkruan dietat dhe mënyrën e shëndetshme te të ushqyerit; • Përshkruan rëndësinë e aktiviteteve fizike dhe ndikimet në peshën trupore dhe pubertet; • Diskuton përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të dietave në fëmijëri;
<p>Vetëdijesimi për ndikimin e përdorimit te substancave që krijojnë varshmëri</p>	<p>Substancat dhe medikamentet</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan pasojat që sjell pirja e duhanit në organizmin e njeriut dhe përshkruan presionin e bashkëmoshatarëve në përdorimin e duhanit; • Përshkruan pasojat që shkakton konsumimi i alkoolit dhe drogave në organizmin e njeriut dhe në marrëdhëniet familjarë dhe shoqërorë;
<p>Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm</p>	<p>Mjedisi natyror dhe artificial</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan dobitë e shfrytëzimit të mjedisit natyror për aktivitetet e ndryshme fizike dhe sportive; • Dallon përparësitë dhe dobësitë e shfrytëzimit të mjediseve artificiale; • Tregon ndikimin e mjedisit dhe alergjive në shëndetin e njeriut.

4. Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në lenden Edukatë fizike, Sportet dhe Shëndeti, mund të përdoren metodat e ndryshme të punës me qëllim të arritjes së rezultateve të kompetencave, të cilat metoda janë të përbashkëta për të gjitha fushat, përfshi edhe fushën Edukate Fizike Sporti dhe Shëndeti. Në kuadër të kësaj, fokusi i mësimdhënësit duhet të jete në zbatimin e metodologjive, të cilat sigurojnë një mësimdhënie gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit siç janë:

- Mësimdhënie dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirja;
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në qasjen e integruar;
- Mësimdhënie dhe nxënie të bazuar në arritjen e kompetencave;
- Mësimdhënie dhe nxënie të diferencuar;
- Çështje/tema ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare.

Për arritjen e rezultateve të kompetencave të fushës përveç metodave të përbashkëta, secila lëndë mësimore ka edhe veçantitë e saja për organizimin e punës mësimore.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave dhe teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike duke pasur gjithnjë parasysh dhe sigurinë e nxënësit.

Organizimi i mirë i procesit të mësimin të kësaj lënde, do të thotë, që nxënësit të vendosen edhe në situata konkrete praktike, ku zhvillojnë dhe zbatojnë elementët lëvizorë e sportivë. Aktiviteti lëvizor, (loja dhe sporti), janë një punë serioze, që dominon shumicën e jetës së tyre shkollore dhe jashtë saj, duke ua zënë pjesën më të madhe të kohës e të energjisë, duke krijuar aftësi, shkathtësi dhe formuar sjellje shoqërore, si kontribut themelor në kërkesën për rritjen e shpejtë dhe të shëndetshme.

Në orët e mësimin të edukimit fizik sportit dhe shëndetit, duhet t'i vihet theks i veçantë mbajtjes së higjienës, pjesëmarrjes së aktiviteteve fizike, për t'i mësuar nxënësit se si të ruajnë pastërtinë dhe të kujdesen për higjienën e trupit gjatë dhe pas çdo aktiviteti fizik. Gjatë këtyre orëve mësohen praktika të sigurta, të cilat, nëse ndiqen nga nxënësit gjatë gjithë jetës së tyre, do t'i parandalojnë ata nga sëmundjet e ndryshme.

Edukimi fizik dhe sportiv e gjen veten mjaft mirë si komponent i edukimit artistik, sepse janë të ndërlidhur me njëri - tjetrin, pasi që vejnë në lëvizje gjithë trupin e njeriut. Sinkronizimi dhe ritmi si aftësi koordinative, janë pjesë përbërëse të edukimit fizik e artistik, të cilët së bashku ndihmojnë në një zhvillim dhe formim më të plotë të nxënësit.

5. Udhëzime për çështjet ndërkurrikulare

Trajtimi i çështjeve ndërkurrikulare në kuadër të fushës është një aspekt me shumë rëndësi, pasi mundëson integrimin e fushave kurrikulare dhe lëndëve mësimore, me qëllim të përkrahjes së nxënësve që të kuptojnë dhe interpretojnë drejt proceset shoqërore dhe natyrore që ndodhin në shoqëri. Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbytjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave KKK.

- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Shfrytëzimi medies
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm Gjuha dhe Shkathtësitë e Komunikimit
- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë
- Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm

Në përgjithësi rezultatet e fushës i prekin çështjet nderkurrikulare, andaj kujdes do t'i kushtohet trajtimit adekuat edhe në programet lëndore. Megjithatë, parësore është puna e mësimeve, të cilët gjatë punës së tyre t'i kushtojnë kujdes çështjeve nderkurrikulare që në fazën e planifikimit gjithmonë të analizojnë, tema apo njësi mësimore me të cilat çështje nderkurrikulare ndërlidhet në mënyrë, që të sigurohet mësime e integruar, e cila synon përfshirjen e të gjitha aspekteve të rëndësishme shoqërore, të trajtohen nga lëndë të ndryshme dhe me këndvështrime të ndryshme e që mundësohen edhe arrijtjet e kompetencave të përcaktuara me KKK.

6. Udhëzime për vlerësim

Fusha e kurrikules Edukatë Fizike, Sporte dhe Shëndeti, për shkak të natyrës dhe specifikave që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive të zbatojnë në praktikë njohuritë e mësuara në jetën e tyre të përditshme.

Një aspekt që duhet të merret në konsideratë është edukimi shëndetësor, për shkak të specifikave që ka, do të ishte e vlefshme që përveç vlerësimit numerik të aplikohet në masë të madhe vlerësimi përshkrues, pasi që në pjesën më të madhe kemi, të bëjmë me vlera dhe qëndrime të cilat nuk preferohet të maten me anën e testeve. Për t'i matur dhe për t'i vlerësuar ato përdoren instrumente të tjera. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë është një procedurë e përshtatshme për fushën: Edukimi Fizik, Sportet dhe shëndeti, dhe që mund të përdoret në situata të ndryshme mësimore dhe në të gjitha nivelet e shkollimit.

Qëllim i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si: qëndrimet etike-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësimeve zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi, si për shembull:

- Përshkrim gojor të lëvizjeve që duhet përmirësuar.
- Përdoren fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit dhe aktiviteteve të ndryshme
- Teste të standardizuara me shkrim.
- Pjesëmarrja aktive gjatë orës mësimore.
- Ese (hulumtim individual apo grupor për temat e edukimit shëndetësor)
- Video incizimet.
- Korrigjim i lëvizjeve të gabuara me takt.
- Numri përsëritjeve të veprimit lëvizor mbi bazën e aftësive individuale.
- Distanca e arritur në metra nga veprimi lëvizor mbi bazën e aftësive individuale.
- Vlerësimin i kompleks ushtrimeve me pikë.
- Vlerësimi i kompleks ushtrimeve të veçanta me pike.
- Vlerësimi me pike i elementeve kompozuese në gjimnastikë sportive dhe ritmike.
- Vlerësimi i elementeve teknike me pikë.
- Vlerësimi me teste të njohurive për edukim shëndetësor.
- Vlerësimi në bazë të listës së kontrollit.

Këtyre vlerësimeve mund t'u shtohen edhe vlerësimet për pjesëmarrje në veprimtaritë e ndryshme sportive. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet, ndërsa demonstroi arritjet e tij, duke u shfaqur nëpërmjet veprimtarive të tjera, si: merr pjesë në veprimtari të ndryshme sportive, apo sportive-artistike, që organizon shkolla etj. Në angazhimin e nxënësve me grupe apo skuadra të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënësi në veçanti.

7. Udhëzime për materialet didaktike, burimet dhe mjetet mësimore

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore Edukatë Fizike, Sportet dhe shëndeti, është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që i motivojnë nxënësit dhe stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të krijojnë shprehje dhe shkathhtësi të nevojshme për jetë. Meqenëse tekstet shkollore janë burime të vlefshme dhe të rëndësishme të të nxënësve, qasja e nxënësve në informacion nuk duhet të kufizohet vetëm në tekstet shkollore, por edhe në burime të tjera, të cilat i shërbejnë për të planifikuar dhe për të realizuar procesin mësimor në klasë.

Për realizimin më të suksesshëm të fushës mësimore Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti, duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet shkollore, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Mësimdhënësit dhe nxënësit mund të angazhohen në hartimin dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore, p.sh.: rezultatet e projekteve të realizuara nga nxënësit mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.



**FUSHA
KURRIKULARE**

**JETA
DHE PUNA**

Programi mësimor: Teknologji me TIK

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzime metodologjike
5. Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare
6. Udhëzimet për vlerësim
7. Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

1. Hyrje

Përmes kësaj fushe të Kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do ta zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin për ekzistimin e mundësive të orientimit profesional (përzgjedhja e profesionit), përdorimit të TIK-ut.

Të nxënit në fushën e Kurrikulës Jeta dhe Puna nxënësve u mundëson:

- Të kuptuarit dhe ushtrimin e punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.
- Ngritjen e kualiteteve personale për jetë dhe për punë.
- Të kuptuarit dhe përdorimin e teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme.
- Përdorimin e TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.
- Ushtrimin e zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit (simulimi)!
- Promovimin e kushteve të sigurta për jetë dhe për punë.
- Përgatitjen për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme (pikëpamjet).
- Lehtësi komunikimi në / për jetë dhe për punë.
- Gatishmëri për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit.

Në këtë fushë në klasën VI-të si lëndëbartse është Teknologji me TIK ku dhe përfshihet një përqindje e madhe e konceptit kryesor të kësaj fushe. Planprogrami i krijuar për këtë klasë fokusin kryesor e ka tek kjo lëndë.

Bashkë me lëndën Teknologji me TIK do të zhvillohen disa module të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës Jeta dhe Puna për shkallën 3 si Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë, Puna dhe Edukimi për ndërmarrësi si dhe Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Lënda Teknologji me TIK synon të zhvillojë shkathtësitë praktike tek nxënësit duke filluar me përdorimin e letrës, drurit, veglave të punës, zhvillon të menduarit kritik gjatë krijimit të modeleve në praktike, gjithashtu nxitë bashkëpunimin, punën në grupe dhe projekte të ndryshme.

Kjo lëndë lidhet ngushtë me Shkencat e natyrës / Fizikën ku dhe synohet të ketë një korelacion paraprak me temat dhe qëllimet kryesore të të dy lëndëve.

Ndërsa, tek konceptet si Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë do të zhvillohet moduli i cili bazohet në literaturën e krijuar nga ekspertët për këtë koncept.

2. Qëllimi

Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë nxënësit drejt arritjes së kompetencave, rezultateve të fushës dhe lëndës përmes praktikës dhe planprogramit gjithpërfshirës. Gjithashtu të përgatisë nxënësit dhe t'i orientojë ata drejt qëllimeve të veta, orientimin në karrierë, dhe mësimin epjesëve të teknologjisë, prodhimit të letrës, drurit, përdorimin e tyre në praktikësi dhe realizimin e projekteve përmes mësimëve praktike.

3. Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e gjashtë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Jeta dhe Puna, të shkallës së tretë të kurrikulës (Shk 3) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Teknologji duke përfshirë TIK-un	<p>RNF:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet. <ol style="list-style-type: none"> 1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedisin shkollor dhe në komunitet. 1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar. 2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë. <ol style="list-style-type: none"> 2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike. 3. Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme. <ol style="list-style-type: none"> 3.1 Përshkruan dhe analizon doracakët për vegla dhe makina të ekonomisë familjare. 3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime. 4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. <ol style="list-style-type: none"> 4.1 Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara. 	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	Materialet dhe përpunimi ityre	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon vetitë elementare të materialeve të cilat përdoren në industri dhe teknologji. • Paraqet format e përpunimit të letrës përmes shembujve praktik. • Përshkruan përpunimin dhe prodhimin e drurit. • Përshkruan metodat e përpunimit dhe formimit të materialeve, fazat e punës. • Shpjegon se ç'është lënda e parë, gjysmëprodhimet dhe prodhimet finale.

		<ul style="list-style-type: none"> • Përdor veglat e punës dhe makinat elementare për aktivitete të ndryshme në klasë. • Përshkruan rrugën e ecurisë prej idesë deri te prodhimi. • Përdor fjalor përkatës për lexim dhe emërtim të dokumentacioneve teknike. • Përshkruan metodat e përpunimit dhe formimit të materialeve (druri, letra), fazat e punës. • Tregon përdorimin e teknologjisë në mjedis nga hulumtimi i bërë në internet dhe libra të ndryshëm. • Diskuton rëndësinë e pyjeve për shëndetin e njeriut. • Merr pjesë në organizime të ndryshme për ruajtjen e ambientit. • Bënpunime të ndryshe me materiale ricikluese. • Identifikon materialet plastike të riciklueshme dhe ekologjike si dhe ato të pareciklueshme.
	<p>2. Njeriu dhe shoqëria në teknologji</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon përdorimin e teknologjisë në mjedis nga hulumtimi i bërë në internet dhe libra të ndryshëm • Dallon ndotje të ndryshme nga teknologjia në mjedisin shkollor. • Tregon ndikimin e teknologjisë në mjedisin ku jetojmë. • Harton një plan për parandalimin e ndotjeve nga teknologjia dhe mbrojtjen nga pajisjet teknologjike të dëmshme për shëndetin. • Kryen aktivitete praktike për të kuptuar realisht ndotjen nga teknologjia.

	<p>3.Shkathësitë e dizajnit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Skicon prodhimin e thjeshtë sipas:vetive të materialit, funksionit, estetikës, çmimit, etj. • Vizaton objekte nëpërpjesë të ndryshme bazuar në madhësinë e objektit duke paraqitur funksionimin e tyre. • Përshkruan rëndësinë e krijimit të një projekti për realizimin e punëve të caktuara. • Vizaton planin e situatës dhe hollësitë e tij për objekte të ndryshme sipas udhëzimeve.
	<p>5. Teknika bujqësore dhe e ndërtimitarise</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan mënyrat e ndërtimit tradicional dhe bashkëkohor. • Përshkruan përbërjen e objekteve nga elementët e ndryshëm të ndërtimitarisë në forma të ndryshme. • Shpjegon parimet elementare të operacioneve punuese të makinave bujqësore dhe të ndërtimitarisë. • Shpjegon përbërjen e elementëve të ndërtimitarisë. • Shpjegon me anë të shembujve konkret përdorimin e makinave. • Krijon një model të makinave bazuar në skicë me materiale nga druri në kabinet.
	<p>7.Teknologjia e Informimit dhe e komunikimit</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor Movie Maker për krijimin e film-it për metrazhin e shkurtër nga fushat e ndryshme. • Krijon planin për format e ndryshme të komunikimit/sis. kompjuterik. • Komunikon me pajisje teknologjike për shkëmbimin e informatave. • Kryen procedurën për vizatim, llogaritje, regjistrim përmes kompjuterit,IPAD. • Bën mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e kompjuterit përmes programeve aplikative duke identifikuar problemet kryesore në sistemin operativ. • Krijon fajlla dhe foldera për akvizimin dhe krijimin e dokumenteve të reja.

		<ul style="list-style-type: none"> • Krijon dokumente me prgramet Paint,- Calculator,Movie Maker. • Kryen veprime tëndryshme me pajisjet IPAD,PC, Windoës Phone për të kuptuar rëndësinë e aplikimit të tyre në jetën tonë. • Kryen veprime me pajisjet IPAD,P-C,Mob për të operuar dhe ruajtur shënimet e ndryshme në to. • Paraktikon mësiminpërmes lojërave nëMavis Beacon. • Paraqet grafikisht lidhjen LAN dhe WLANduke treguar aplikimin dhe rëndësinë e tyre. • Krijon storie digjitale me programe kompjuterike (p.sh., Movie Maker).
<p>Këshillim dhe orientim në karrierë</p>	<p>RNF:</p> <p>1.Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.</p> <p>1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar.</p> <p>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë.</p> <p>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.</p> <p>4.Përdorimi i TIK-ut për të avansuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme.</p> <p>4.1Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara.</p> <p>7.Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme.</p> <p>7.1Shfaq qëndrime vendimmarrëse në situata të ndryshme duke dhënë arsytim mbi vendimet që merr.</p> <p>8.Komunikimi në / për jetë dhe punë</p> <p>8.1Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.)</p>	
	<p>Tema</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p>
	<p>8. Këshillimi dhe orientimi në karrierë</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Planifikon hapat për karrierën bazuar në vendimmarrje. • Zgjeron njohuri, krijon shprehi humltimi duke shfrytezuar burime te ndryshme me qellim zbulimi te dëshirave dhe aftësive per nje karriere te synua

		<ul style="list-style-type: none"> • Hulumton metoda planifikimi dhe prezanton model plani per te ardhmen e tij. • Përdor komunikmin elektronik për çështje të ndryshme oorientimi më karriere. • Kryen punë praktike në ekip duke treguar forma të ndryshme hulumtimi per profesion.
<p>Puna dhe edukimi për ndërmarrësi</p>	<p>RNF: RNF:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet. <ol style="list-style-type: none"> 1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedis shkollor dhe në komunitet. 2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë <ol style="list-style-type: none"> 2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike 3.Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme <ol style="list-style-type: none"> 3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe Udhëzime 4.Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme <ol style="list-style-type: none"> 4.1 Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara 6.Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë <ol style="list-style-type: none"> 6.1 Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë 8.Komunikimi në / për jetë dhe punë <ol style="list-style-type: none"> 8.1Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.) 	
	<p>Tema</p> <p>9. Krijimi i vlerave</p>	<p>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezanto ide kreative. • Krijon vlera – me mbetje nga materialet e ricikluara. • Ekspozon punimet – vlerat e krijuara. • Puna ne grupe: Aktivitet brenda shkolle duke shitur produkte qe i kanë krijuar nxënësit qe te përfitojë te ardhura.

Edukim për zhvillim të qëndrueshëm	<p>RNF:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet. <ol style="list-style-type: none"> 1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedis shkollor dhe në komunitet. 1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar. 2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë. <ol style="list-style-type: none"> 2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike. 3.Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme. <ol style="list-style-type: none"> 3.1Përshkruan dhe analizon doracakët për vegla dhe makina të ekonomisë familjare. 4.Përdorimi i TIK-ut për të avansuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme. <ol style="list-style-type: none"> 4.1Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara. 5.Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit <ol style="list-style-type: none"> 5.1Kupton aspektin etik dhe ekonomik të ekonomisë familjare e në veçanti veprimet kursimtare në familje. 7.Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme <ol style="list-style-type: none"> 7.1.Shfaq qëndrime vendimmarrëse në situata të ndryshme duke dhënë arsyetim mbi vendimet që merr. 8.Komunikimi në / për jetë dhe punë <ol style="list-style-type: none"> 8.1Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.) 	
	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)
	4.Shkathësitë e të punuarit	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pershkruan përpunimin e letrës dhe të drurit nëpërmjet aktiviteve praktike. • Punon në mënyrë të pavarur objektet të ndryshme nga druri dhe letra duke përdorur veglat elementare. • Skicon modele të ndryshme me anë të mjeteve të punës për realizimin praktik të tyre(modeli i varëses,urës). • Kryen aktivitete praktike në mënyrë të pavarur nga letra dhe druri me veglat elementare(maketa,modele të shtepise,urës).

	<p>6. Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan qarkun elektrik me burim tensioni, me çelës dhe me shpenzues duke identifikuar kushtet e nevojshme që në qarkun elektrik të rrjedhë rryma; • Përshkruan simbolet elementare elektrike si dhe përdorimin e tyre në qarkun elektrik. • Përshkruan burimet e ndryshme të energjisë elektrike, baterinë, dinamon, akumulatorin, gjeneratorin, celulën diellore etj. • Paraqet praktikisht një shembull të funksionimit të një pajisjeje elektrike shtëpiake me kompjuter, hap pas hapi. • Skicon skemat e lidhjeve tëndryshme.
--	--	---

4. Udhëzime metodologjike

Metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies përkufizohet si : sistem të strategjive, të metodave, të mënyrave e parimeve, mjeteve e teknikave, të cilat na shërbejnë si bazë për ndërtimin e konceptit të mësimit ose për organizimin e dhënies së mësimit në shkollë.

Në KKK-në e re metodologjitë bazë të mësimdhënies janë :

Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen: që si pjesë e saj në Teknologji me TIK mësimdhënësi/ja duhet të mbështetet në parimin e gjithëpërfshirjes, i cili merr parasysh dhe adreson stilet e ndryshme të të nxënit, mënyrën dhe shpejtësinë me të cilën mësojnë nxënësit, si dhe aspektet e tjera të diversitetit të nxënësve, duke përfshirë gjininë, moshën, kulturën, prejardhjen shoqërore dhe ekonomike, si dhe nevojat e veçanta të nxënësve, qoftë për aspektet e nxënies plotësuese qoftë për ato të nxënies shtese.

Si metodologji tjetër me rëndësi të madhe është edhe mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca ku përmes aktiviteteve praktike, instrumenteve në orë mësimore mund të aplikojmë zhvillimin e kompetencave si mendimtar kreativ, nxënës i sukseshëm etj.

Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar- nxënësit në këtë pjesë synohet të angazhohen në forma sipas stileve të të nxënit dhe formave të paraqitjes së ideve të tyre. Duke planifikuar mësimin, aktivitetin, instrumentet në formën e individit, jo të grupit, atëherë themi se kemi analizuar secilin nxënës në orë duke arritur nxënien e diferencuar.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në çështjet ndërkurrikulare *Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të realizohet përmes:*

- gjetjes së korrelacioneve midis lëndëve/ temave apo njësive mësimore me qëllim të realizimit të ndonjëres nga kompetencat, p.sh., nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, ajo ndërlidhet edhe me çështje gjuhësore, letrare, teknologjike por edhe me matematikë, edukatë qytetare etj., (shih në KB).

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në çështjet jashtëkurrikulare një metodë ku nxënësit mund të zhvillojnë aktivitete jashtëmësimore p.sh.: vizita në Mekatronikë, në pyje, nëfabrikë

të tekstilit etj.

Metodologjia ndërlidhë përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve në të nxënit e fushave mësimore me rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore – për shkallë dhe nivele.

Thuajse, e gjithë veprimtaria e fushës Jeta dhe Puna bazohet në punën praktike. Metodrat që përdoren te kjo fushë duhet të mundësojnë konkretizimin e teorisë në praktikë.

Të nxënit në bashkëpunim të mundur që nxënësit të nxënë në mënyrë aktive dhe të shprehin shkathtësitë e tyre praktike. Të nxënit në bashkëpunim nxit të menduarit e rendit të lartë, ngre motivimin dhe moralin, mësohen shprehitë ndërvetjake, nxit mirëkuptimin midis nxënësve dhe grupeve etj.

5. Çështje ndërkurrikulare

Në kuadër të fushës kurrikulare Jeta dhe Puna, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj është realizimi i çështjeve ndërkurrikulare. Kjo do të ndihmojë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera, janë:

- Njohja e medias
- Zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit
- Barazia gjinore dhe toleranca;
- Puna vullnetare.
- Edukimi për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore.
- Shkathtësitë e buta për jetë.

Më shumë për këto çështje konsultojeni Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.

6. Udhëzime për vlerësim

Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënit në nivel shkalle kurrikulare (kujto RNSH-kompetenca dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore e të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime, duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht KB-të (Kapitulli VII). Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve që janë planifikuar në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore. Mbi mesataren e vlerësimit të vazhdueshëm, respektivisht mbi mesataren aritmetike të notave numerike që nxënësi është vlerësuar nga mësimdhënësi gjatë tërë vitit shkollor, bëhet vlerësimi përfundimtar në nivel klase dhe për secilën fushë kurrikulare, lëndë mësimore, nxënësit i vendoset nota shkronjë/numër, siç është paraparë në KB-të. Me të njëjtën procedurë duhet vazhduar me vlerësimin edhe në klasat pasuese përbrenda

shkallës së caktuar kurrikulare dhe kështu për të arritur të vlerësimi përmbyllës në nivel shkalle kurrikulare (lexo procedurat e vlerësimit përfundimtar dhe përmbyllës në KB-të, kapitulli VII.)

Nëse dëshirojmë të matim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim këtë procedurë:

- Së pari, për fushën e caktuar kurrikulare, përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i matim;
- Pastaj përcaktojmë nivelin e arritjes të kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate, siç e dimë, duhet të arrihen deri në fund të shkallës dhe nuk janë të zbërthyer. (Kujto zbërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë ! Shih pjesën e udhëzuesit II.3.1, Rezultatet e të nxënësve për shkallë –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre shembullin e zbërthimit të rezultatit III.3, IV.1 (niveli III) dhe IV.1.(niveli II);
- Më pas caktohet tema apo njësia mësimore përmes së cilës matim rezultatin e kompetencës;
- Në fund caktohen kriteret e vlerësimit dhe teknikat e instrumentet adekuate përmes së cilave maten rezultatet e kompetencave (RNSH-të).

Si mund të bëhet vlerësimi i arritjes së rezultateve të të nxënësve përmes njësisë mësimore?

Pasi keni përzgjedhur njësinë mësimore që do të zhvilloni në ditët në vijim, hartojeni një plan vlerësimi për këtë njësi. Përcaktoni rezultatet e të nxënësve mbi bazën e RNSH dhe RNF (RNL), zgjidhni një teknikë të vlerësimit dhe caktoni kriteret e suksesit (kujto planifikimin e orës mësimore).

Njëra ndër strategjitë për vlerësim është edhe **Rubrika** që mund të përdoret nga vetë nxënësit për matjen e nivelit të arritjes së tyre. Kjo strategji e vlerësimit bazohet kryesisht në rezultatet e të nxënësve të orës mësimore (plani i orës mësimore). Arritja e rezultateve demonstron në bazë të shkallës së përmbushjes së aktiviteteve. Secila shkallë e arritjes përcaktohet sipas ngjyrave.

Dosja (portfolio)

Është një koleksion i qëllimshëm i punimeve të nxënësve, që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në fushë mësimore të caktuar. Këtu përfshihet pjesëmarrja e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes, udhëzimet për përzgjedhje dhe kriteret e vlerësimit për të dëshmuar për meritat dhe dëshmitë e vetëreflektimit të nxënësit.

Ky lloj i vlerësimit është vlerësim për të nxënë (vlerësim formativ), pasi që për një kohë të gjatë vazhdimisht mblidhen informata për zhvillimin e nxënësit.

7. Materialet dhe burimet mësimore

Planifikimet mësimore me qasje të re u mundësojnë mësimdhënësve të jenë autonomë në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimdhënies dhe gjithashtu të materialeve mësimore.

Mësimdhënësit, mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të

mësimdhënies, përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuara dhe parimeve të KKK-së. Përzgjedhja adekuate e materialeve konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit të shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë.

Sot, teksti mësimor nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësit, sepse nuk mund t'i përcjellë zhvillimet e shpejta që po ndodhin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore dhe gjithashtu nuk është i përshtatshëm për gjithë nxënësit/et të së njëjtës moshë sa u përket niveleve të njohjes.

Kjo na bën me dije se mësimdhënësit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuara. Shumë aktivitete mësimore mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësimdhënësit, por edhe nga vetë nxënësit, ***kujto të nxënët duke vepruar!***

Krijimi i këtyre materialeve mund të bëhet edhe me materiale ricikluese, si letër, gazeta, rroba të vjetra, ambalazhe të ushqimeve, copëza të drurit, gjethe, litarë, kopse rrobash... etj, respektivisht me gjëra të cilat mund t'i ketë çdo shtëpi dhe që nuk i përdor më. Gjithashtu, në disa raste mësimdhënësit së bashku me nxënës mund t'i riciklojnë edhe vetë.

Si materiale për klasën e gjashtë mund të përdoren druri, letra, ngjitësi, pastaj mjetet e punës duhet të përshtaten moshës së nxënësve dhe të sigurohet forma e parandalimit të rrezikut në punë praktike.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara mësimdhënësi mund të përdorë burime të ndryshme, qoftë elektronike, por edhe të shkruara, si: librat të punës, broshura, atllase, enciklopedi, softuerë arsimore, projekte, studime të ndryshme, analiza etj.

Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme didaktike përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

Kontribuesit në përgatitjen e programeve lëndore për këtë klasë

Për të qenë më afër përdoruesve të këtij materiali dhe me qëllim që në vazhdimësi të ofrohen sqarime shtesë gjatë zbatimit të programeve lëndore për këtë klasë, në tabelën e mëposhtme gjeni emrat dhe kontaktet e koordinatorëve dhe zëvendës-koordinatorëve të fushave kurrikulare.

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Kontakti
1.	Agim Bërdyna	Zv/Ministër Aspektet e përgjithshme të KK	agim.berdyna@rks-gov.net
2.	Alush Istogu	U.d. Sekretar i MASHT Aspektet e përgjithshme të KwK	alush.istogu@rks-gov.net
3.	Osman Buleshkaj	Këshilltar i jashtëm për Kurrikula Aspektet e përgjithshme të KK	obuleshkaj@gmail.com
4.	Mustafë Kadriu	U.d. Drejtor i DZhAP për Aspektet e përgjithshme të KK	mustaf.kadriu@rks-gov.net
5.	Shqipe Gashi	Koordinatore – KSNA1 Aspektet e përgjithshme të KK	shqipe.z.gashi@rks-gov.net
6.	Labëri Luzha	Zv/Koordinatore –KSNA 1 Aspektet e përgjithshme të KK	laberi.luzha@rks-gov.net
7.	Ismet Potera	Koordinator – KSNA 2 Aspektet e përgjithshme të KK	ismet.poter@rks-gov.net
8.	Shejnaze Elezi	Zv/Koordinatore – KSNA 2 Aspektet e përgjithshme të KK	shejnaze.elezi@rks-gov.net
9.	Selim Mehmeti	Koordinator – KSNA 3 Aspektet e përgjithshme të KK	selim.mehmeti@rks-gov.net
10.	Radica Berishaj	Zv/Koordinatore – KSNA 3 Aspektet e përgjithshme të KK	radica.berishaj@rks-gov.net
11.	Feime Llapashtica- Lipscomb	Koordinator për fushën Gjuhët dhe komunikimi	feime.llapashtica@rks-gov.net
12.	Nizafete Kutllovci- Bardhi	Zv/Koordinator për fushën Gjuhët dhe komunikimi	nizafete.bardhi@rks-gov.net
13.	Besa Luzha	Koordinator për fushën Artet	besa.luzha@gmail.com
14.	Haki Xhakli	Zv/Koordinator për fushën Artet	hakixhakli@gmail.com
15.	Mustafë Kadriu	Koordinator për fushën Matematika	mustaf.kadriu@rks-gov.net
16.	Fatmir Elezi	Zv/Koordinator për fushën Matematika	fatmir.elezi@rks-gov.net
17.	Rexhep Kastrati	Koordinator për fushën Shkenca natyrore	rexhep.kastrati@rks-gov.net

18.	Mirlinda Dehari-Zeka	Zv/Koordinatore për fushën Shkencat natyore	mirlinda.zeka@rks-gov.net
19.	Igballe Cakaj	Anëtare për fushën Shkencat natyrore	igballecakaj@rks-gov.net
20.	Arbër Salihu	Koordinator për fushën Shoqëria dhe mjedisi	arber.salihu@rks-gov.net
21.	Besa Halimi	Zv/Koordinator për fushën Shoqëria dhe mjedisi	besa.h.zagragja@rks-gov.net
22.	Lulavere Kadriu-Behluli	Koordinatore për fushën Edukata fizike,sportet dhe shëndeti	lulavere.behluli@rks-gov.net
23.	Leonora Shala	Zv/Koordinatore për fushën Edukata fizike,sportet dhe shëndeti	leonora.shala@rks-gov.net
24.	Agim Bytyqi	Koordinator për fushën Jeta dhe puna	agim.a.bytyqi@rks-gov.net
25.	Ryve Prekorogja	Zv/Koordinator për fushën Jeta dhe puna	ryve.prekorogja@rs-gov.net
26.	Shyhrete Reçica	Koordinatore për fushën Kurrikula me zgjedhje	shyhrete.reqica@rks-gov.net
27.	Lirije Gosalci	Zv/Koordinatore për fushën Kurrikula me zgjedhje	lirije.gosalci@rks-gov.net